



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.11.2018, ora 13:00

Drejtton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Prezantimi i Buxhetit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nga ministri, z. Peleshi, lidhur me shqyrtimin e projektligjit “Për Buxhetin e vitit 2019”
(Komision për dhënie mendimi)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatjana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Fadil Nasufi.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka, Rahman Rraja, Gjetan Gjetani dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Niko Peleshi – Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Ilir Halilaj – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Aurora Alimadhi – Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Irfan Tarelli – Drejtor i Përgjithshëm i politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural.

Agron Vata - Drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Fatjon Hoxhalli – Këshilltar për Mediat në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Fillojmë mbledhjen për buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Kemi të ftuar ministrin, zotin Peleshi, të cilit i uroj mirëseardhjen në komision, zonjën Aurora Alimadhi, zotin Irfan Tarelli, zotin Ilir Halilaj, zotin Agron Vata dhe zotin Fation Hoxhalli. Relator është zoti Besnik Baraj.

Pa humbur kohë i japim fjalën ministrit për prezantimin e buxhetit pastaj të vijojmë me pyetjet, përgjigjet dhe komentet nga kolegët nëse do të ketë.

A jeni dakord me rendin e ditës? Dakord.

Zoti Peleshi, fjala për ju.

Niko Peleshi – Faleminderit për ftesën!

Do mundohem të flas shkurt, për të bërë një prezantim sintetik të buxhetit në mënyrë që të kemi mundësi për pyetje apo diskutime nga anëtarët e nderuar të këtij komisioni. Buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural këtë vit është në vlerën 10 miliardë e 854 milionë lekë. Krahasuar me vitin e kaluar është pothuajse në të njëjtin nivel, pra plus, minus 1%, por duke marrë në konsideratë që ministria jonë nuk e ka më përgjegjësinë e administrimit të ujërave, për këtë vit ne kemi më shumë burime sesa vitin e kaluar, sepse vetëm shpenzimet për administrimin e ujërave shkonin 60 milionë lekë.

Ne kemi bërë një ndarje të buxhetit si: Shpenzimet operative 177 milionë lekë,

investime të brendshme 247 milionë lekë dhe investime të huaja 3 miliardë e 92 milionë lekë. Investimet e huaja siç duket janë të mëdha, sepse këtu përfshihet edhe kontributi për IPART-in, por edhe kontributi për veprën më të madhe ujitëse e Ministrisë së Bujqësisë, që është një program i mbështetur nga Banka Botërore për zonën Lushnje, Fier, Divjake dhe për zonën e jugut. Pra është vazhdimi i projektit të mëparshëm dhe bëhet fjalë për një për një projekt prej 23 milionë eurosh. Gjatë këtij viti është parashikuar të përthithen rreth 7 milionë lekë nga ky projekt.

Në sektorin tonë kemi 6 programe dhe i pari është programi i zhvillimit rural. Përpara se të zbërthejmë programet, dua të them se ne e shohim bujqësinë shqiptare të ndarë në dy kategori, njëra është bujqësia komerciale dhe tjetra është bujqësia e fermave të vogla. Bujqësia komerciale është padyshim është ajo që na jep konkureshmëri më të lartë dhe eksporte në rritje nga vitit në vit. Edhe ky vit ruan trendin e rritjes së eksporteve, por është pjesa më e vogël e totalit të prodhimit bujqësor vendas, ndërsa pjesa më e madhe, pra 95% e bujqësisë prodhohet për nevojat e vendit. Kjo është po kaq e rëndësishme sa eksportet, sepse

zëvendëson importet. Trendi i rritjes së prodhimit vendas dhe i zëvendësimit të importeve përmes prodhimit vendas, po rritet gjithnjë e më tepër nga viti në vit.

Nga ana tjetër kjo bujqësi që i jep kaq shumë vendit, familjeve fermerë i jep pak, sepse numri i familjeve fermerë që jeton në zonën rurale është shumë i lartë, ferma mesatare është e vogël 1 deri në 1.3 hektar në mesataren e vet dhe të ardhurat që siguron bujqësia për familjen fermere janë shumë të pakta dhe të pamjaftueshme për mbi 85% të fermerëve në fshat, për sa kohë që nuk janë plotësuar me të ardhura të tjera dytësore.

Për bujqësinë e fermave të vogla ne jo vetëm llogarisim rritjen e mbështetjes për ekonominë bujqësore, por nga viti i kaluar dhe do të vazhdojmë edhe këtë vit të mbështetemi shumë fort dhe duam ta mbështesim akoma më tepër diversifikimin e ekonomisë. Si e mbështesim? E mbështesim përmes skemave tona të mbështetjes financiare. Duke filluar nga janari i vitit që vjen ne do të kemi aktive dy skema mbështetëse, skemën kombëtare mbështetëse, e cila ka ekzistuar edhe më përpara, por që nga viti i kaluar është rritur dhe ka shkuar në 2.6 miliardë lekë këtë vit, pra janë rreth 20 milionë euro të skemës kombëtare. Gjithashtu dhe skemën e madhe të financimit përmes IPARD-it, i cili është një program i Bashkimit Europian dhe i qeverisë shqiptare, pra është bashkëfinancim dhe kap vlerën e 94 milionë eurosh. Sot që flasim është shpallur formalisht thirrja për IPARD-in. Deri në datën 30 nëntor jemi në fazën informimit dhe trajnimit të konsulentëve të AZHBR-së, nga 30 nëntori dhe deri në fund të janarit presim aplikimet për IPARD-in, i cili ka tre fusha kryesore, mbështet investime në fermë, në agrobiznes dhe në diversifikimin e ekonomisë. Vetëm nga IPARD-i kemi 11 milionë euro në dispozicion që nuk janë për një vit, por për të gjithë harkun kohor të IPART-it që është 3 plus 2 vjet. Këto nuk janë pak për të diversifikuar ekonominë në zonat rurale me ekonomi të tilla si agroturizmi, punishtet e prodhimeve tradicionale tipike, për të cilat po hartojmë draftligjin, dhe ekonomi të tjera ndihmëse që mund të plotësojnë dhe ta bëjnë reale qasjen tonë për të ndërtuar mirëqenien në fshat.

Edhe një herë po kthehem atje ku e fillova, ne vazhdojmë ta ndajmë në dy pjesë bujqësinë, në atë komerciale dhe të fermave të vogla. Për bujqësinë komerciale si pjesë e programit të zhvillimit rural është shtyrja përpara për kooperimin. Pas vitit të parë, me shumë sukses mundëm të zgjidhim disa ngërçe që na i lidhnin duart dhe të drejtën për të folur dhe promovuar kooperimin, pra për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor për shkak se kishte ngarkesa fiskale. Tani që ne kemi hequr TVSH-në e shoqërive të bashkëpunimit bujqësor, pra rimbursohet 100%, kemi mundësi që t'i japim shpejtësi kooperimit të fermerëve. Edhe një herë ju rikujtoj që në bazë të vendimeve të marra nëse fermerët bashkohen në një shoqëri bashkëpunimi bujqësor, ata kanë të drejtë të shesin pa tavan të sipërm me rimbursim 100% të

TVSH-së përmes autofaturimit të grumbulluesve. Pra, pak a shumë siç funksionojnë fermerët e vegjël, të cilët kanë një nipt fermeri, por që realizojnë një gjiro më pak se 5 milionë të reja. Për SHPB-të ky tavan është hequr. Ne do të vazhdojmë edhe incentiva të tjera. Në skemën tonë kombëtare gjithmonë SHPB-të do të trajtohen me prioritet dhe me më shumë mbështetje, duke marrë më shumë subvencion për mbledhjet e reja apo për të gjitha masat e mbështetjes.

Ndërkohë që bujqësia komerciale vitet e fundit çelësin e suksesit e ka te shtimi i kapaciteteve grumbulluese dhe përpunuese, pra i pikave të grumbullimit. Ne do të vazhdojmë t'i mbështesim edhe përmes IPARD-it dhe përmes skemave të tjera për rritjen e numrit, por edhe shtimin e kapaciteteve të pikave të grumbullimit në të gjithë vendin, sepse një pikë grumbullimi e fortë do të thotë një bujqësi rreth kësaj pike grumbullimi me treg shitjesh të garantuara dhe të shëndetshme.

Pra dy instrumentet kryesore të zhvillimit rural, që do të jenë vitin që vjen, janë skema kombëtare dhe IPARD-i, ku sfida më e madhe do të jetë absorbimi i të dyja skemave. Pra brenda vitit 2019 nga 94 milionë fonde të IPARD-it ne duhet me doemos të absorbojmë 13 milionë, sepse pjesa e fundit që nuk absorbohet konsiderohet e djegur.

Ne kemi nevojë edhe për mbështetjen tuaj për të bërë një korrektim në buxhet, për sa i përket buxhetit për Agjensinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, ku janë zhvendosur 100 milionë lekë, pra rreth 1 milion dollarë, që duhet të kthehen përsëri aty si me rialokime të brendshme, por aq më mirë kur rialokojmë me shtesa nga hapësira të tjera, sepse është thelbësore që AZHBR-ja të ketë kapacitete të mjaftueshme për të absorbuar më mirë IPARD-in. Nëse cungojmë apo tkurim kapacitetet dhe buxhetet e Agjencisë natyrisht që kjo reflekton në një eficiencë më të ulët në drejtim të absorbimit të fondeve të IPART-it dhe të skemës kombëtare. Kjo është teknike, por besoj se do ta tejkalojmë. Ne duhet që të rikthejmë në buxhetin e AZHBR-së këtë fond të vogël në raport me të tërën, por të domosdoshëm për të siguruar suksesin e AZHBR-së vitin që vjen.

Eduard Shalsi – Më fal, kjo është hequr?

Niko Peleshi – Është hequr dhe është 100 milionë më pak.

Eduard Shalsi – Në krahasim me vitin që kaloj?

Niko Peleshi – Në krahasim me nevojën. Edhe po ta krahasojmë me vitin e kaluar është përsëri më pak. Më shumë pranohet të jetë, por më pak nuk ka kuptim, sepse tani shumëfishohet volumi i punës për AZHBR-në.

Eduard Shalsi – Dakord. Se nga do t'i marrim nuk është vendosur akoma?

Niko Peleshi – Në rastin më të keq mund t'i bëjmë brenda ministrisë me rialokimet. Por më e mira do të ishte që të sigurohen shtesa. Ne kemi këtë 100 milionësh dhe një 100

milionësh tjetër, që do ta sqaroj më poshtë se përse është e domosdoshëm. Pra minimumi që duhet të plotësohet është 200 milionë lekë. Çdo ministri ka kërkesa pafund dhe ne kemi listën tonë të kërkesave shtesë, por jemi të vetëdijshëm edhe për faktin që gjithmonë nevojat janë më të mëdha se mundësitë.

Programi i dytë është siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit, ku qëllimi është fuqizimi i sistemit të kontrollit dhe i inspektimit, duke përfshirë të gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë.

Për sa i përket kuadrit ligjor ne kemi dy zhvillime të rëndësishme për sigurinë ushqimore. Kemi rishikuar dy ligje, kemi bërë drafte dhe ligjet janë gati për t'u qarkulluar në ministri, të aprovohen në qeveri dhe menjëherë të vijnë brenda pak javësh në parlament. Bëhet fjalë për rishikimin e ligjit të ushqimit dhe ligjin për shërbimin veterinar. Më e rëndësishmja që synojmë të arrijmë është të japim kontroll më të mirë në të gjithë zinxhirin ushqimor, konkretisht nga ferma në tavolinë, për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit nga njëra anë dhe nga ana tjetër të shmangim amullinë që krijohet për shërbimin veterinar, kur janë disa operator privat, publik, qendror dhe vendor. Këta ne do t'i thjeshtojmë, për shembull: veterinerët e bashkisë do t'i kalojnë shërbimit shtetëror veterinar, pra nuk do të ketë edhe bashkia, edhe ministria jonë shërbim veterinar, por do të ketë vetëm ministria. Numri i veterinerëve në territor do të trefishohet sipas llogaritjeve tona dhe synojmë që minimalisht të kemi një veteriner për një njësi administrative. Ky është sistemi ku duhet të shkojmë. Çdo njësi administrative do të ketë veterinerin e vet, njësitë që kanë më shumë blegtori mund të kenë edhe më shumë se një veteriner, por minimalisht një veteriner që ka një mbulim shumë të qartë për një territor gjeografik, siç është njësi administrative, do ta kemi vitin që vjen për të gjithë Shqipërinë. Ky veteriner do të jetë përgjegjës për të gjitha shërbimet e nevojshme dhe të detyruara të fermave në atë zonë. Kryesorja është vaksinimi dhe matrikullimi, pra janë dy procese që akoma nuk e kemi fituar betejën dhe akoma nuk janë disiplinuar siç duhet, por që janë jetike dhe shumë të rëndësishme për sigurinë ushqimore dhe për shëndetin publik në përgjithësi.

Ajo që ndryshon për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit është që nëse deri sot Autoriteti nuk ka të drejtë të hyjë në fermë, kur ka indice për problematika ushqimore që burojnë nga ferma, me ndryshimet e ligjit të ri një inspektor nga Autoriteti do të ketë të drejtë të kontrollojë nga ferma deri në tavolinë.

Ne jemi duke kaluar disa provime shumë të rëndësishme për sigurinë ushqimore nga grupe auditimi nga Bashkimi European. Kaluam me sukses kontrollin e përpunimit të peshkut, i cili ishte me të vërtetë një provim i vështirë. Kjo do të thotë që ne vazhdojmë ta

kemi të hapur tregun për eksportet e peshkut në Bashkimit European. Eksporti i peshkut është rritur këtë vit në mënyrë të jashtëzakonshme. Në 6-mujorin e parë të këtij viti kishim 55% më tepër eksporte dhe kjo i alarmoi në kuptimin e mirë të fjalës strukturat e Bashkimit European, të cilët ndërmorën një auditim, por në fund u mbyll pozitivisht dhe ne vazhdojmë ta kemi të hapur tregun për eksportin e peshkut.

Ndërkohë që sapo kemi kaluar edhe auditimin e programit të planit të menaxhimit të mbetjeve, nga audituesit e Bashkimit European. Nuk kemi marrë akoma zyrtarisht rekomandimet e tyre, por shpresojmë që të jenë pozitive. Këto rekomandime janë shumë të rëndësishme, sepse në rastin ekstrem mund të ketë mbyllje të eksporteve kur ne nuk arrijmë dot t'i bindim për kontrollin mbi menaxhimin e mbetjeve, në rastin konkret. Sipas bisedave që kam pasur personalisht do të kemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bëhet fjalë për mbetjet në produkte dhe jo për mbetjet urbane.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndotjet në produktet ushqimore dhe jo mbetjet. Ne jemi të informuar që do të kemi disa rekomandime të forta dhe të detyrueshme për t'u realizuar në muajt në vazhdim që kërkojnë edhe burime. Pra edhe këtu një 100 milionësh është po aq i rëndësishëm sa tek Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural. Pra te programi i sigurisë ushqimore duhet të riallokojmë, pra të rikthejmë 100 milionë lekë, sepse pa këto shpenzime operative nuk mund të plotësojmë rekomandimet e audituesve të Bashkimit European, që janë vendimtare për vazhdimin e eksporteve të produkteve tona.

Programi i tretë është menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes. Siç e thashë është projekti më i madh me Bankën Botërore, me një shumë prej 23 milionë eurosh. Këtë vit janë parashikuar 750 milionë euro. Në këtë drejtim kemi kërkesa plot dhe nuk mjaftojnë ndoshta 10 buxhete për të plotësuar nevojat për ujitje kullimi dhe mbi të gjitha për parandalim përmbytjesh, sepse problematika e mbartur është shumë e madhe. Në vendin tonë kemi lumin më të egër në Europë që është Vjosa dhe që është gjithmonë kërcënim për rajonin. Presioni është shumë i madh për të vënë dore, sepse vende të tjera për fat të keq i kanë disiplinuar duke i shfrytëzuar për prodhime energjie, por ne duam ta ruajmë atë si pasuri natyrore, e kemi angazhim kombëtar dhe ndërkombëtar ta ruajmë, por nga ana tjetër, kjo ka kostot e veta. Duke qenë lum i egër, është vështirë të disiplinohen ujërat e tij dhe përmbytjet po bëhen gjithnjë e më të shpeshta. Kemi aplikuar për të marrë një fond për studimin e fizibilitetit të Vjosës dhe 2-3 lumenjve të tjerë. Shpresojmë të kemi përgjigje pozitive, ndërkohë kemi bashkëpunim edhe me shtete partnere si Turqia dhe Sllovenia. Pas ca ditësh

do të pres në takim zëvendësministrin e Bujqësisë të Turqisë dhe tema kryesore e diskutimit do të jetë pikërisht bashkëpunimi në fushën e parandalimit të përmbytjeve. Gjithsesi, për shumë e shumë vjet nevojat për investime do të mbeten shumë më të mëdha se mundësitë që ne kemi. Ky është një vit ku ne do të adresojmë disa prej nevojave për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet. Kryesori është programi i Bankës Botërore prej 23 milionë eurosh. Këtu dua të bëj një kërkesë për të cilën kemi marrë angazhimin nga Ministria e Financave, për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes së Bankës Botërore duhet një shtesë prej 1 miliard e 478 milionë lekë financim të huaj dhe 470 milionë lekësh financim të brendshëm, që duhen të parashikuar në tavanin buxhetor. Si financim e kemi, por duhet rritur tavani buxhetor. Ministria e Financave e ka premtuar.

Programi tjetër është ai i mbështetjes së peshkimit. Ne kemi performancë shumë të mirë të peshkimit dhe të përpunimit të peshkut. Natyrisht, kemi probleme dhe sfida që duhen përballuar, siç është çështja e molusqeve, e midhjeve. Në fakt, jemi ende larg standardeve të kërkuara, por edhe aty kemi ndërmarrë aksione shumë të forta për disiplinimin, ndërkohë do të vazhdojmë edhe me skemën e re të subvencionojmë açugen dhe sardelen e kapur, me origjinë shqiptare. Ne japim 20 lekë të rinj për kilogram për açugen dhe sardelen, sepse duam të inkurajojmë sektorin vendas të investojë për peshkimin. Industria jonë e peshkimit, le të themi, 70% të peshkut e merr nga importi. Synimi ynë është rritja e përqindjes së peshkut me origjinë shqiptare, për këtë arsye kemi filluar subvencionimin për kilogram të açuges dhe sardeles.

Programi tjetër është programi i këshillimit dhe informacionit bujqësor. Jemi në mes ose afër fundit të reformës së ristrukturimit të ish-drejtorive të Bujqësisë, tani kemi dy agjenci të reja: Agjencinë e Zhvillimit dhe të Ekstensionit Bujqësor, dhe Agjencinë e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve. Jemi në procesin e plotësimit të strukturave dhe burimeve njerëzore të këtyre agjencive. Agjencia e Zhvillimit Veterinar do të ketë një numër të dyfishuar të fermerëve me një qasje të re të mbulimit gjeografik të tyre.

Kemi bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës, i cili në vitin që vjen do të konkretizohet për të filluar trajnimin e ekstensionistëve dhe certifikimin e tyre. Kemi bërë gati modulën e trajnimit të tyre. Në një hark kohor prej disa javësh, do të kemi ekstensionitë jo vetëm të shtuar, por edhe të kualifikuar. Fatkeqësisht moshë mesatare e agronomëve dhe ekstensionistëve sa vjen e rritet, por ende më keq është për ekstensionistët, sepse nuk mjafton të kesh diplomë në agronomi për të qenë i aftë të shërbesh dhe të këshillosh fermerët.

Gjithashtu, numri i fermerëve është shumë i madh, ndonëse të vegjël, prandaj mbulimi i tyre është i vështirë. Në drejtim të këshillimit dhe informacionit bujqësor kemi një bashkëpunim që tani po konkretizohet.

Tani jemi në mes të punës për ngritjen e një kanali televiziv, në bashkëpunim me Radiotelevizionin Shqiptar, për një kanal të posaçëm për bujqësinë, i cili do të quhet RTSHAgro dhe është pjesë e kanaleve të RTSH-së. Ne kemi dhënë një kontribut nga buxheti prej rreth 100 milionë lekësh të rinj, pra rreth 1 miliard dollarë, ndërkohë edhe Radiotelevizioni Shqiptar ka ngritur ekipin e tij rreth këtij kanali, që do të jetë 24 orë shërbim këshillimi për bujqësinë dhe zhvillimin rural në vendin tonë. Në këtë mënyrë do të arrijmë të hyjmë në shtëpinë e çdo fermeri, përmes teknologjisë, sepse me ekstensionistë fizikë është e pamundur.

Ndërkohë, po bëjmë disa investime në qendrat e transferimit të teknologjive bujqësore. Vitin që vjen, duam t'i fuqizojmë këto qendra, janë 5 të tilla në të gjithë Shqipërinë.

Programi i gjashtë është ai i menaxhimit të qëndrueshëm të tokës bujqësore. Këtu po vazhdojmë punën për të rritur numrin e AMTP-ve të regjistruara. Zhvillimi më i rëndësishëm, që nuk është vetëm i ministrisë sonë, por ne jemi pjesë e këtij procesi, është hartimi e legjislacionit të ri dhe reformës institucionale të pronës, ku pa dyshim çështja e titujve të pronësisë të tokës bujqësore ka një peshë specifike shumë të madhe në raport me të tërën. Është ngritur dhe funksionon nën drejtimin e ministres së Drejtësisë, Komiteti për Menaxhimin e Integruar të Tokës. Ne kemi hartuar draftligjet, madje prej 5 ditësh ka filluar edhe konsultimi publik. Objektivi është që brenda këtij viti të miratojmë dy ligjet, një ligj për përfundimin e proceseve tranzitore, dhe ligji tjetër për kadastrën. Miratimi i këtyre dy projektligjeve hap rrugën për ngritjen e institucionit të ri të pronës që do të ketë brenda vetes edhe disa agjenci, që lidhen me pronësinë, si: ZRPP –ja, AMTP-ja, ALUIZNI dhe Agjencia e Trajtimit të Pronës për kompensimin financiar dhe fizik të ish- pronarëve.

Duke i vendosur nën një ombrellë institucionale dhe nën një hartë të unifikuar edhe çështja e regjistrimit të titujve të pronësisë së tokës bujqësore do të marrë një shpejtësi tjetër zgjidhjeje, shumë herë më të lartë se deri tani. Ne besojmë se me këtë zhvillim do të përmbushim angazhimin dhe zotimin politik të qeverisë shqiptare që brenda këtij mandati ta kemi mbyllur çështjen e titujve të pronësisë së tokës bujqësore në të gjithë vendin. Kjo do t'i hapte rrugë dhe do të energjizonte tregun e tokës, të qiramarrjes, qiradhënies, shitjes, blerjes së tokës e të tjera. Me këtë ligj çështja e shumëfolur, por pak e bërë e titujve të pronësisë së tokës në zonën e veriut, por jo vetëm, merr zgjidhje. Në veri në shumë zona për arsye edhe të

traditës, dhe e normave të tyre komunitare, ligji nr. 7501 nuk ka funksionuar fare ose nuk ka funksionuar siç duhet, por ndërkohë të gjithë përdoruesit e tokës atje e kanë gjetur paqen me njëri-tjetrin, janë vendosur në kufij për të cilët kanë rënë dakord. Çështja është që sot janë të pa pajisur me dokumente pronësie. Nuk kanë një titull pronësie në dorë dhe kjo bëhet shumë kritike sot kur për të gjithë vendin është rritur mundësia e mbështetjes financiare, kujtoj IPARD-in ose skemën kombëtare. Pa pasur një dokument pronësie për tokën nuk mund të aplikosh, por të mos përfitosh nga këto skema, do të ishte një mëkat. Është një problem i mbartur prej 27 vjetësh, por të paktën tani jemi duke e zgjidhur. Koha për realizimin e këtij objektiv, miratimin e këtij ligj është fundi i këtij viti. Zbatimi i tij dhe pajisja me dokument të ligjshëm të përdorimit ose pronësisë së tokës bujqësore në zonën e veriut ose në çdo zonë tjetër ku ligji nr. 7501 ka funksionuar çalë-çalë ose nuk ka funksionuar fare do të fillojë në fillim të vitit të ardhshëm. Kjo do të na jepte një dorë shumë të fortë për të futur në hartën e bujqësisë formale, ose të bujqësisë që mbështetet financiarisht edhe ato zona që sot i kemi totalisht jashtë hartës.

Programi i 7 është ai i planifikimit të administrimit të menaxhimit, që është pjesë e çdo buxheti. Këtu nuk po zgjatet.

Eduard Shalsi – A ka pyetje?

Zoti Baraj.

Besnik Baraj –342, 6 milionë lekë për peshkimin janë kryesisht për açuge. Në kushtet kur ne importojmë 70% të produkteve të detit, si është e mundur që janë kaq pak fonde për mbështetjen e këtij sektori kaq të rëndësishëm ekonomik?

Para disa vjetësh ne kemi diskutuar këtu në komision dhe jemi bërë pengesë për ngritjen e fermave në Gjirin e Vlorës, për shkak se në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor u konfirmua që dëmi që sjellin ato në zonat ku kultivohen është jashtëzakonisht i madh në pikëpamje mjedisore, aq më tepër në një zonë siç është Gjiri i Vlorës, ku shpejtësia e qarkullimit të ujërave është e ngadaltë. Është shfaqur shqetësim, po prapë nga ana mjedisore, por ka persona në fushën e biznesit që kanë tendencë për të ngritur atje fermat për kultivimin e peshkut. Doja të dija si është situata dhe kur parashikohet që të na vijë ne në komision një hartë në lidhje me zonat ku parashikohet që mund të kultivohen këto konform kriterëve që ndjekin vendet e rajonit?

Greqia nuk lejon fare në zona të mbyllura si Gjiri i Vlorës, aq më tepër kur Gjiri i Vlorës ka statuse e vlera të veçanta për të parandaluar eutrofikimin e ujërave e të tjera.

Niko Peleshi - Buxheti prej 342,6 milionë lekë është buxheti i ministrisë për peshkimin, kemi drejtorinë e Peshkimit në ministri, kemi edhe Agjencinë e Shërbimit për

Peshkimin në Territor dhe inspektorët e peshkimit. Buxheti i shpenzimeve për paga, administrative, operative dhe të brendshme e investime në total është kaq.

Ndërkohë nuk është pjesë e këtij buxheti subvencioni që japim për açuget dhe sardelet, i cili shkon rreth 40 milionë lekë të rinj, të paktën për këtë vit. Vitin e ardhshëm mund ta rritim ose mund ta mbajmë në këtë vlerë.

Ju thoni që është pak, natyrisht nevojat janë shumë të mëdha, por ka edhe disa programe të tjera në bashkëpunim me donatorët në mbështetje të peshkimit. 2 milionë euro është, për shembull, një program në bashkëpunim me kooperacionin italian, që shpresoj do të fillojë për pak javë për të mbështetur industrinë e peshkimit në vendin tonë. Një pjesë e tij është grant.

Kemi edhe një program tjetër me IPA-n, që do të aktivizohet vitin që vjen dhe që do të ketë grante të vogla për peshkimin.

Ka pasur një rritje shumë të madhe, siç e thashë, përpunimi i peshkut në vendin tonë, por është kryesisht industri që punën me fasonëri në 70% të saj, siç e thashë për ne mbetet objektiv të rrisim pjesën që zë peshku me origjinë shqiptare në këtë industri.

Sa u përket zonave të akuakulturës, ju e dini që në ligjin e akuakulturës ka një përcaktim, me sa di unë, ka qenë komisioni juaj që ka insistuar që nuk mund të jepet dot asnjë leje për kultivimin për akuakulturën pa u hartuar një studim integral për gjithë Shqipërinë. Pra, nuk mund të ketë zgjidhje të pjesshme, por zgjidhje integrale për akuakulturën në vend. Kemi në diskutim rishikimin e ligjit të akuakulturës. Ndërkohë, studimin e kemi në plan të mbështetur nga IPA, sepse edhe ai ka një buxhet të caktuar dhe parashikojmë që në vitin 2019 ta përfundojmë. Pasi të jetë përfunduar studimi mund të ketë mundësi për zhvillimin e akuakulturës në mënyrë të kontrolluar në zonat që studimi do të parashikojë.

Besnik Baraj – Kam edhe një problem tjetër me të cilin jam ndeshur këto ditë kur më është dashur të kem një informacion në lidhje me produktet e detit, për shembull, për nivelin e ndotësve të ndryshëm, metaleve të rënda, pesticideve e të tjera. Jam i interesuar të di nëse në institucionet përkatëse që mbulon ministria juaj a kanë informacione, bie fjala që nga viti 2006? A parashikoni që t'i ktheni në formë dixhitale informacionet, që kjo bazë të dhënash të jetë në informim për publikun, por edhe për biznesin, qoftë të brendshëm dhe të jashtëm për të treguar standardet dhe kapacitetet tona të monitorimit dhe të vlerësimit analitik të këtyre produkteve, sepse është një reklamë shumë e mirë që i bëhet, ndërkohë është e pamundur për t'u tërhequr ky lloj informacioni. Ky, sigurisht, nuk është problemi juaj, është i trashëguar, por është fakt.

Niko Peleshi – Nuk është se kam një përgjigje, por vlen si vërejtje nga ana juaj ose si sugjerim. Ne do ta mbajmë shënim dhe do ta diskutojmë për të bërë më tepër. Nuk kam dijeni për ndonjë plan ose projekt konkretisht.

Fadil Nasufi - Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, ministri Peleshi bëri një sqarim shterues për buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, por edhe në materialin e paraqitur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë e mora fjalën edhe për koment, edhe për pyetje.

Dihet se bujqësia është një nga sektorët kryesorë, që ndikon në rritjen e GDP-së, aktualisht kontribuon me rreth 20% dhe presim një trend edhe më në rritje për shkak të potencialit të madh që kjo përfaqëson, por buxheti këtu është edhe afatmesëm, parashikon edhe programe deri në vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2017 ne dolëm me një program dhe në prezantimin publik bëmë disa premtime konkrete. Për shembull, në mandatin e parë realizuam kalimin e sistemit të ujitjes në 225 hektarë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, në 225 mijë hektarë dhe themi se do ta mbyllim deri në 100%, ndërkohë që deri në vitin 2021 ne shikojmë të kalojmë në 360 mijë hektarë, sipas relacionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nejse, unë po flas se si do të ecë tani trendi.

Ndërkohë, si prioritet kemi përjashtimin nga TVSH-ja të inputeve bujqësore, duke kontribuar me 20 milionë dollarë në vit. Natyrshëm pyes: si jemi realisht me këtë premtim, me këtë mundësi, që u japim fermerëve për t'i lehtësuar nga TVSH-ja për inputet ose lidhur me çmimin e karburantit? A kemi deri tani modele bashkimesh të fermerëve deri në 5 hektarë, si një nga format më të gjetura për t'i dhënë impuls zhvillimit të bujqësisë?

Për sa u përket skemave të mbështetjes financiare, që do të trajtohet nga AZHBR-ja, besoj se për të gjithë kolegët ka qenë një telash i madh në ballafaqimet që bëjmë me publikun, ku hasim skema në nivele të larta korruptimi.

Së pari, çfarë risish ka tani?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Korruptimi, para marrjes së ministrisë nga ana juaj.

Ne ndeshemi me të njëjtat shqetësime në komunitetet e fermerëve për mënyrat se si ato menaxhohen dhe janë, si të thuash, larg traditës së keqe që kanë krijuar. Cili do të jetë kontributi i Ministrisë së Bujqësisë në kuadër të programit “100 fshatra turistike” në gjithë kompleksin e aktorëve, që janë përfshirë në këtë angazhim të përbashkët që ne kemi?

Ka një shprehje në relacion: “shtimi i gjobave nga inspektimet”. Unë besoj se duhet të flasim më shumë për ndërgjegjësimin, për ligjshmërinë dhe për rritjen e kulturës sesa të vëmë “gjoba” për titull në materialet e buxhetit, sepse nuk shkon mirë, pavarësisht se ato janë, por nuk mund të futen si një zë që ndikon pastaj edhe në buxhet. Pra, pavarësisht se ndëshkimi dhe zbatimi i ligjshmërisë është prioritet dhe duhet të forcohet.

Për sa i përket ndonjë komenti që mund të keni ju në transferimin e këtyre funksioneve që kanë marrë bashkitë, sidomos për sa u përket skemave të kullimit të ujitjes dhe për mbështetjen që u ka dhënë qeveria atyre, edhe me transfertën specifike, që kthehet në transfertë tani të pakushtëzuar, ashtu edhe nëpërmjet mbështetjes me mjete motorike dhe ekskavatorë, çfarë impakti ka dhënë? A ka ndonjë ndryshim pozitiv? Se, në fund të fundit, nuk është thjesht kompetencë pushtetesh, por ne na dhemb ose jemi të interesuar se e gjetëm rrugën e duhur dhe jemi në ndihmë të fermerëve dhe të zhvillimit të bujqësisë.

Çështja e fundit që kam, në fakt, e përmendët edhe ju, ka të bëjë me përmbytjet. Parashikohen këtu 16 kilometra argjinatura për mbrojtjen, por nuk e di se ku do të gjenden realisht burimet e financimit, pasi nga buxheti i shtetit janë të pamundura. Por ne ballafaqohemi me riciklim të situatave të përmbytjeve dhe heqim sikletin e radhës apo, si të thuash, kostot e radhës nga pamundësia e ndërhyrjeve në skemat e mbrojtjes nga përmbytjet e lumenjve, si Osumi i Beratit, që është aq agresiv, sa çdo vit, sa herë ka reshje, ndodhin situata të tilla.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Po, zoti Ministër.

Niko Peleshi – Janë shumë pyetje, por do të mundohem që t’u përgjigjem shkurtimisht secilës.

Për sa i përket ujitjes, duhet të themi se kemi pasur rezultate shumë të mira këto vite për ujitjen: kemi dyfishuar sipërfaqen e ujitur. Do të përpiqemi ta arrijmë si objektiv. Me thënë të drejtën, vetëm me fonde buxheti është shumë e vështirë, por, për fat të mirë, kemi programe me donatorë, siç është ai i Bankës Botërore, në vlerën 23 milionë euro, që është vazhdim i projektit të mëparshëm. Gjithashtu, kemi shumë besim te rezultatet e decentralizimit të ujitjes dhe kullimit, të paktën për kanalet e dyta dhe të treta të bashkitë.

Ju pyetët: “Si ka shkuar, si ka funksionuar”? Për mua është një histori suksesi, nuk flas personalisht, por institucionalisht. Ne e monitorojmë ujitjen deri te fermeri. Pavarësisht se kanalet e dyta dhe të treta nuk janë më të Ministrisë së Bujqësisë, por të bashkive, me thënë të vërtetën, e kanë bërë punën shumë më mirë sesa bordet e djeshme të kullimit.

Pa dyshim që janë pajisur nga qeveria qendrore para tre vjetësh me ekskavatorë, i cili ka qenë një kontribut tejet i rëndësishëm, ku 61 ekskavatorë kanë qenë për të gjitha bashkitë. Pra, pothuajse çdo bashki ka marrë një ekskavator, me disa përjashtime, por kanë marrë edhe financim.

Tani transfertat e pakushtëzuar është rritur dhe brenda kësaj transferte kanë mundësi ta përdorin një pjesë të burimeve, për të mbështetur projektet e tyre të ujitjes dhe të kullimit. Kemi besimin se do të vazhdohet të punohet po kaq mirë.

Kryetarët e bashkive, falë reformës administrativo-territoriale, tani nuk janë më me profil urban, por kanë edhe profil rural, çka do të thotë se duan, nuk duan, duhet ta marrin këtë profil dhe me të vërtetë që po performojnë mirë edhe në fshat.

Janë të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë, në mazhoritar, si dhe janë tejet të interesuar që të kenë rezultat në territor, pasi japin llogari dhe një kryetar bashkie mund ta kapësh shumë më kollaj se sa drejtorin e një bordi kullimi.

Për sa u përket shoqërive të bashkëpunimit bujqësor, siç e thashë, këtë vit kemi ndërmarrë incentiva të forta: i kemi futur në rimbursim 100% të TVSH-së, pa tavan, por rezultati nuk mund të jetë brenda vitit, ndonëse që këtë vit janë shtuar 13 shoqëri të tilla. Do të vazhdojmë ta mbështesim me incentiva, por edhe me avantazh të shtuar, të siguruar në skemën kombëtare të mbështetjes, të paktën të skemës sonë kombëtare, se IPARD-i është pak më i ngurtë si program, nuk mund të preket kaq kollaj.

Për sa i përket rritjes së transparencës së Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, pra të administrimit të skemave të mbështetjes, ne do të vazhdojmë ta shtrijmë dhe ta perfeksionojmë politikën e “zero dokumente”-ve, sepse aty fillonte loja, te mali i madh i dokumenteve, te burokracia fshihet korrupsioni. Kur ka shumë burokraci, ka shumë mundësi për të dhënë dhe për të marrë ryshfet.

Duke e çuar në zero dokumente të gjithë procesin e aplikimit, si dhe duke e bërë atë online këtë vit (vitin e kaluar duhet të paraqiteshin te zyrat e AZHBR-së, tek agropika apo kush nuk kishte agropikë të paraqitej te Drejtoria e Bujqësisë), pra këtë vit mund të shkosh atje, të aplikosh tek agropika, por ne do të japim mundësinë të aplikohet edhe drejtpërsëdrejti nga celulari apo nga kompjuteri. Kush nuk është i familjarizuar me teknologjinë, mund të shkojë ta marrë asistencën tek agropika, por kush e ka të mundur, vetë ose nëpërmjet të afërmeve, familjarëve, mund ta kryejë nga shtëpia e tij, nga celulari, ku mund të mbushë një formular të thjeshtë aplikimi, pa dokumente, dhe pastaj vetëm kur të shpallet fitues, është i detyruar të provojë vërtetësinë e të dhënave që ka deklaruar. E theksoj, edhe këtu nuk do të kërkohej prova për setin e 13 dokumenteve, sepse për pjesën më të madhe (pothuajse për

dhjetë ose njëmbëdhjetë prej tyre), të dhënat merren automatikisht nga sistemet dixhitale, që sot i kemi të ndërlidhura njëra me tjetrën.

Në fakt, programi “100 fshatrat” ka marrë vëmendjen e të gjithë qeverisë, duke u bërë kështu një program kombëtar, do të thosha, dhe ka një koordinator kombëtar pranë zyrës së Kryeministrit. Po bëjmë një punë mjaft të mirë, që ndonjëherë nuk është shumë e prekshme, por është e domosdoshme: po hartojmë projektet për këto 100 fshatra, duke angazhuar pothuajse 100 studentë dhe pedagogë të Universitetit publik të Arkitekturës dhe Urbanistikës, të cilët janë shpërndarë nëpër Shqipëri dhe po hartojnë fishat e projekteve, si dhe dizajnin (projektet arkitekture-urbanistike). Dihet se pa pasur projekte nuk mund t’i realizojmë dot ato, ndaj po e kryejmë me shpejtësi fazën e parë të projektimit. Mund të themi se deri tani është bërë një punë fantastike, një punë mjaft e mirë, nisur edhe nga fakti se të gjithë këta janë arkitektë të rinj ose studentë, çka i ka dhënë një lloj freskie edhe ideve të zhvillimit rural, i cili deri dje konsiderohej vetëm si shtrimi i rrugës apo i kanaleve, pra vetëm investime shumë bazike dhe me kërkesë të vetë fshatrave. Ndërkohë, sot ne po e hapim pak lojën, duke ndërtuar disa modele edhe me investime kreative, që pastaj do të fillojnë të fusin një kulturë të re të zhvillimit rural në vendin tonë.

Zhvillimi rural, ndonëse mund ta kemi veshin të vrarë, në praktikë nuk mund të them se ka ndodhur gjë në të kaluarën; nuk ka pasur një politikë të qartë për zhvillimin rural. Them se programi “100 fshatrat” do të bëjë shumë, por me pak. Pra, sado me pak burime, do të japë një impakt shumë të madh në të gjithë vendin, sepse të paktën do të jetë një model në çdo bashki që u tregon edhe të tjerëve rrugën në të cilën duhet të ecin, por, mbi të gjitha, zgjon një lloj besimi, një lloj shprese dhe optimizmi se e nesërmja e fshatit mund të jetë më e mirë.

Ju ngritët çështjen e TVSH-së së inputeve bujqësore. Është e vërtetë se ky është një angazhim jo vetëm elektoral, por edhe pjesë e programit të qeverisë. Në fakt, jemi angazhuar që brenda këtij mandati të shkojmë drejt heqjes së TVSH-së së inputeve bujqësore, por lajmi i mirë për të gjithë të interesuarit, për të gjithë fermerët, është se ndoshta që këtë vit, me këtë buxhet, do të arrijmë ta akomodojmë, sepse ka një angazhim tejet të vendosur të Kryeministrit, në fakt, i cili na ka kërkuar vetë të gjithëve: Ministrisë së Financave, neve (ministrave) dhe komisioneve parlamentare që të shikojmë mundësinë e akomodimit në këtë buxhet të heqjes së TVSH-së së inputeve bujqësore.

Unë kam përgatitur një grafik vetëm sa për informacion, pasi kam bërë një diskutim shumë interesant me zotin Beqaj. Në total, ajo çka ne marrim si TVSH nga inputet bujqësore është rreth 9 milionë euro dhe, me të drejtë, zoti Beqaj më ka thënë: “Dakord, ja po e heqim TVSH-në e inputeve bujqësore. Duke e parë si numër, ne i kemi hequr sektorit 9 milionë euro

nga barra fiskale. E pjesëtuar kjo me numrin e madh të fermerëve, ngelet një kontribut shumë i vogël”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Madje ka shumë të drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në atë këndvështrim, po.

Tani, nisur edhe nga ai diskutim, por e kishim edhe në proces, bëmë një analizë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, në total nevojat vjetore për inpute bujqësore, vetëm për pesticide dhe vlera kimike, nuk po flas për farat dhe fidanët...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë, se nuk po them që nuk do të futen, por se grafiku flet vetëm për pesticidet dhe plehrat kimike! Ndërkohë, propozimi është që nga TVSH-ja të përjashtohen edhe farat e fidanët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë po ilustruj vetëm këto të dyja.

(Deputeti Beqaj flet pa mikrofon.)

Jo medikamentet veterinarë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

As ushqimet për blegtorinë.

Ilir Beqaj – Po materiali gjenetik mbjellës?

Niko Peleshi – Po, hyn te farat dhe fidanët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë, propozimi është të përjashtohen të gjitha inputet bujqësore (farat, fidanët, pesticidet dhe plehrat kimike). Për të gjitha këto inpute vlera e TVSH-së që ne marrim është 9 milionë euro. Por unë po ju prezantoj vetëm grafikun për pesticidet dhe plehrat kimike, pra vetëm për një pjesë të inputeve bujqësore.

Nevojat vjetore të bujqësisë janë 128 milionë euro. Kjo shifër ka dalë, referuar... Ilir?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Analizë e brendshme, por bazuar ku?

Ilir Halilaj – Bazuar te nevojat për sipërfaqet e mbjella...

Niko Peleshi – Por cilat norma kemi marrë si referencë? Nga e ke marrë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – Për sipërfaqet dhe të gjitha kulturat?

Ilir Halilaj – Për sipërfaqet dhe të gjitha kulturat e mbjella në to aktualisht. Pra, jo për sipërfaqet e pakultivuara.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Pra, nevoja vjetore është 128 milionë euro, ndërkohë që ne importojmë 25 milionë euro pesticide dhe plehra kimike, ndërsa në vend nuk prodhojmë gjë, domethënë importojmë vetëm 16% të nevojës vjetore. Çfarë është tani 84%-shi? Është informalitet dhe/ose mostrajtim. Kjo do të thotë se, për shkak të mungesës financiare, fermerët tanë thjesht nuk i përdorin. Madje është e vërtetë se ne përdorim shumë më pak inpute (pesticide dhe plehra kimike) sesa vendet e zhvilluara. Kjo vlen edhe për të adresuar shqetësimin e shumë konsumatorëve, të cilët, nisur edhe nga alarmi i medieve, mendojnë ndonjëherë se fermerët tanë abuzojnë dhe e ekzagjerojnë me përdorimin e kimikateve të ndryshme në trajtimin e produkteve bujqësore. Kjo nuk është e vërtetë, në fakt, edhe për arsyen për të cilën po flasim, edhe për mungesat e burimeve financiare. Pra, nuk i kemi aq të pasur fermerët sa që të bëjnë tridhjetë ose dyzetë spërkatje të pemëtores në vit, por bëjnë shumë pak. Ndoshta Greqia apo vende të tjera mund të bëjnë 30-40 spërkatje, por ne shkojmë te 10, 12 ose 15 maksimumi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

84%-shi është ose mungesë trajtimi, ose informalitet.

Ne kemi informacion se informaliteti, për fat të keq, është i lartë në zonat kufitare, pasi një pjesë e madhe e këtyre inputeve nuk janë voluminoze (kanë vlerë të madhe, por volum të vogël) dhe mund të futen kontrabandë edhe në një çantë. Mund të kenë vlerën e disamijë eurove...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, në qoftë se ne heqim barrën fiskale, heqim TVSH-në, kontrabanda nuk do të ketë më kuptim. Nuk ka pse t'i fusin kontrabandë, por do t'i fusin formalisht nga dogana. Domethënë, edhe përfitimi i shtetit do të jetë më i madh, sepse do të rritet norma e formalizimit, por edhe, nga ana tjetër, besoj se i japim përgjigje shqetësimit ose pyetjes së ngritur nga zoti Beqaj, që është edhe pyetja jonë, nëse heqja e TVSH-së së inputeve bujqësore do të japë vërtetë impakt apo është një gjë e vogël që do të tretet në mënyrë të pandjeshme në treg.

Ne kemi bërë studim edhe për vendet e rajonit. Kosova, për shembull, me të cilën jemi edhe komplementarë, edhe konkurrentë, e ka 0% TVSH-në e inputeve bujqësore; Maqedonia e ka 10%, por e ka sa gjysma jonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fakt, të gjitha vendet e tjera, me të cilat ne konkurrojmë, e kanë maksimalisht 10% (pra 10 e poshtë), ndërsa ne e kemi 20%, çka nënkupton se jemi të disavantazhuar. Kjo është edhe arsyeja pse qeveria shqiptare e ka futur në programin e saj heqjen e TVSH-së së inputeve bujqësore. Pa dyshim që kjo do të bëhet gradualisht. Shpresojmë që një hap të parë shumë të rëndësishëm, bazuar te vullneti i shprehur i Kryeministrit, ta realizojmë që këtë vit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Mund ta ezaurojmë këtë meqenëse jemi, sepse...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm diçka. Para se t'ia jap fjalën zotit Beqaj, në një nga mbledhjet e komisionit dy-tre javë më parë, zoti Ministër, është kërkuar një informacion.

Duke iu referuar të dhënave të INSTAT-it, në mos gaboj, zoti Beqaj ka kërkuar një shpjegim pse rritja e sipërfaqes nën ujë, rreth 225-230 mijë hektarë, nuk ka sjellë pasoja në rritjen e prodhimit.

Nga punonjësit e ministrisë u kërkua një përgjigje, që komisioni nuk më rezulton ta ketë marrë në dorëzim. Do të doja ta mbani shënim si rast. Nëse punonjësit tuaj marrin përsipër një angazhim (nuk e di se cilit person iu drejtuan pyetjet atë ditë)...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ishte Enea Hoti me Festimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, do të doja ta mbanit shënim, si rast.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Iu referova këtij rasti, se nuk vetëm rasti i kësaj ministrie, por do të doja ta mbanit shënim, sepse kur merrni angazhime para deputetëve në komision për pyetjet, t'u përgjigjeni.

Kjo ishte në formë vërejtjeje.

Vijojmë me diskutimin për imputet bujqësore. Si komision kemi marrë një angazhim për imputet bujqësore. Mbasi kemi diskutuar edhe me ministrin dhe ka sjellë një material zëvendësministri, bashkë me Komisionin e Ekonomisë dhe po më thonë se edhe Kryeministri sapo deklaroi që është i vendosur në mbledhjen e grupit (unë s'kam qenë në atë mbledhje), që betejën për çështjen e imputeve bujqësore, do ta vijojmë. Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kishit diçka për këtë pikë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni!

Ilir Beqaj – Ne jemi nisur fillimisht nga ajo shifër që na është bërë prezente. Faktikisht, arkëtohet 9 milionë TVSH imputesh. Nuk e di nëse arkëtohet në doganë apo arkëtohet në rrjetin fundor. Nëse është thjesht në doganë, duhet t'i shtojmë edhe 25%, sepse imputi kalon në hallkat e tregtimit dhe në fund mund të matet më kollaj. Edhe nëse është 12-13 milionë formalisht, krijon një kosto totale diku te 65 milionë lekë. Kjo ka qenë aritmetika. Ju na paraqitët këtë sot. Unë pyeta zëvendësministrin se çfarë modeli keni marrë. Mua më duket se ky është më shumë një model teorik.

Unë po përpiqem që ta shtrijmë edhe në Shqipëri. Ky mund të jetë një model teorik dhe mund të marrë për shembull kaq përqind nga Greqia, apo nga Italia etj., por ne mund të bëjmë edhe një përpjekje tjetër. Kush punon prej vitesh në bujqësi, mund të na ndihmojë për ta nxjerrë këtë gjë. Po marr si shembull vitin 2017. Prodhimi bujqësor ka qenë 2,1 miliardë euro (duke hequr peshkimin dhe pyjet). Ju jeni në gjendje të na hiqni këtu blegtorinë dhe mund të na nxirrni një shifër se sa është bujqësia dhe jeni në gjendje që me nivelin e zhvillimit tonë, të thoni se ky lloj prodhimi nuk mund të bëhet pa kaq impute, për të dalë në një model më shumë shqiptar sesa modeli teorik që keni thënë ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

Po e korrigjoj. Ju thatë nisur nga hektarët, nuk thatë nisur nga prodhimi. Ju thatë: nisur nga hektarët e 330 mijë fermave duhet të përdoren kaq impute. Kjo nuk mjafton se duhet edhe rendimenti. Prandaj po nisem nga prodhimi. Për shembull një prodhim prej 1,5 miliardësh. Nuk e di sa nxjerr blegtoria se nuk i kam parasysh shifrat, por unë mora të dhënat nga INSTAT-i (GDP-në 3-mujore të bujqësisë) dhe hoqa peshkimin dhe pyjet për të lënë vetëm atë, që quhet bujqësi. Nëse mund të na ndihmoni duke thënë se ky prodhim nuk bëhet dot pa pasur minimumi kaq impute, se në fakt nuk bëhet. Këtu mund të shohim që mund të jetë 65 milionë në doganë dhe mund të ketë marzhe të larta në këtë treg. Nuk e di, se nuk kemi bërë ndonjë analizë tregu si punohet me marzhin.

Ju mund ta masni duke u nisur nga mënyra si tregtohet në zonat e kordonit kufitar, ku ka pak kontrabandë, sepse ministri tha me vendet ku konkurrojmë, por kontrabanda bëhet më shumë me vendet fqinje. Ne nuk mund të konkurrojmë me tregjet që s'i kemi fqinjë. Hapësira për kontrabandë vjen nga kordoni kufitar i kontrabandës dhe është një kontrabandë që nuk besoj se bëhet në rrugët e shërbimit doganor. Plehrat për bujqësinë më shumë hyjnë në zonat kufitare, në rrugë, me çanta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ajo nuk është një vlerë shumë e madhe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Biznesi me çanta nuk ka ndonjë vlerë të madhe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, qenka shumë.

Eduard Shalsi – Dakord.

Ilir Beqaj – Nëse mund të na ndihmoni për të bërë këtë lloj vlerësimi, ky prodhim aktual shqiptar, sa impute minimale përdor, që të japë këtë vlerë? E kemi të sigurt që e jep këtë vlerë. Edhe ministri e tha fillimisht, se pak a shumë ne kemi 10% industri në bujqësi dhe 90%, që është vetëkonsum që të mund të arrijmë në një vlerësim se sa është.

Zoti Ministër,

Ne dje patëm një debat këtu se u hap kjo çështje në prani të përfaqësuesve të Ministrisë së Financave dhe sidomos një pjesë e kolegëve tanë kanë pak rezerva edhe për mënyrën se si se na e ngriti Ministria e Financave duke thënë se ju heqim këto, por jua anulojmë skemën e rimbursimit. Ne kemi një ndjesi që skema e rimbursimit po mbetet vetëm te grumbulluesit dhe nuk po zbret poshtë te fshatari.

Kështu, kemi diskutuar edhe në ditë të tjera nga deputetë, që janë më të lidhur me zonat e tyre ku janë.

Unë ua kam shprehur edhe kolegëve, edhe juve, se unë jam pak (kam qenë shumë partizan para 5 vjetësh), ndërsa sot jam më refraktar dhe përdor si kundërshebull vadtjen. Ne kemi pasur 120 në vitin 2013, kemi sot 225. Do të ishte mirë të bënim disa korrigjime, sepse praktikisht po na krijohet kakofoni edhe me këtë shifër. Relacioni thotë që janë potencialisht të ujitshme 360 mijë ha tokë. Në komunikim me ju keni përdorur dy shifra të mëparshme, një herë 300 mijë dhe një herë 270 mijë, apo jo?

Nga ana tjetër, në 3 vjetët e ardhshëm, me aq sa thoni ju në relacion 4,5% si sipërfaqe e vaditur nga shifra potenciale, do t'i shtoni më shumë vetëm 16 mijë ha.

Pyetja që kam bërë edhe kur ka qenë Enea me një përfaqësues tjetër, që ishte për ligjin për mbarështimin e blegtorisë, edhe kur ishte drejtori tjetër, unë u kam kërkuar, që në bazë të të dhënave zyrtare, sipërfaqja e mbjellë apo rendimenti për rrënjë apo për hektarë në këto 5 vjet nuk rezulton i rritur sipas raportimit të INSTAT-it edhe pse ne bëmë shumë investime në ujitje, të cilat pasqyrohen në këto shifra.

Na është dhënë një përgjigje, që mund të jetë me vlerë. Na thanë: po, por me të gjitha këto gjëra që u bënë, ne nuk arrijmë dot te kanalet e treta dhe po nuk u bënë edhe ato, i bie që ky investim ka mbetur potencial. Nëse është kështu, atëherë, duhet të bëjmë edhe një

përpjekje që të mos të vazhdojmë më me të mesmet dhe me të lartat, por të vëmë në eficiencë të ulëtat (kanalet e treta).

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ua kemi lënë bashkive, por kështu i bie që na kanë shkuar dëm investimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk janë akoma efektive, sepse kanalet e treta nuk janë bërë. Kështu na e shpjeguan dhe ndoshta kjo mund të jetë e vërtetë.

Eduard Shalsi – Më fal një sekondë, Beqe!

Për ta ngacmuar pak, unë do të sugjeroj në fund të diskutimit për buxhetin e ministrisë, por zëvendësministri u nis nga disa premisa, duke përmendur edhe sipërfaqen.

Ende kemi mbetur pa përgjigje gjatë gjithë këtyre viteve, se sa është sipërfaqja e tokës bujqësore në vend. Zoti Pjetër i ka mbajtur shënim paradokset e përgjigjeve që kemi marrë në vite nga Ministria e Bujqësisë. Nuk po flasim për diferenca prej 1000-2000-5000 hektarësh. Sikundër janë deklaruar tani 320 mijë fermerë, ndërkohë që në relacionin që keni sjellë, është një shifër prej 270 mijë fermerësh. Ndërkohë, ka një raport të publikuar për 300 mijë fermerë (të vegjël dhe të mëdhenj).

Zoti Ministër,

Është momenti (unë e kam nisur këtë histori dhe do ta theksoj edhe më shumë), që të vendosim rregull në librat e bujqësisë. Ndoshta do të duhet një investim i fortë që do t'i japë një përgjigje disa çështjeve.

Unë, shqetësimin e zotit Beqja në lidhje me pyetjen nëse i është përgjigjur ky investim i madh në rritje prodhimit bujqësor, duke parë shifrat, nuk kam se çfarë t'i përgjigjem. Logjika ma do që të jetë rritur. Në qoftë se 100 mijë ha nën ujë të investuara brenda këtyre viteve nuk kanë sjellë asnjë rezultat, atëherë, më vjen keq, por po rrahim ujë në havan. Unë nuk dua ta besoj që janë 100 mijë hektarë, gjë që do të thotë se baza e të dhënave të INSTAT-it nga e cila krijohen disa opinione, nuk është e saktë. Domethënë, në qoftë se prodhimi ka rënë dhe është e vërtetë ajo që thotë Iliri, ndërkohë që e kemi rritur sipërfaqen e tokës nën ujë, atëherë, ka një gjë të madhe që nuk shkon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është rritur pra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk raportohet, pra po them se baza e të dhënave duhet domosdoshmërisht të saktësohet. Ndoshta duhet të tkurrim financimet. Më pas do ta shoqërojmë me disa pyetje të tjera. Duhet të marrim disa të dhëna të sakta mbi të cilat të merren disa vendime, që të dimë

se çfarë impakti ka. Në qoftë se nuk biem dakord për tokën bujqësore, për numrin e fermerëve, atëherë për çfarë po diskutojmë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka qenë konflikt. Jo, e kemi ezauruar atë. Ministria e Bujqësisë në kohën e kolegut tonë ka bërë çfarë ka dashur vetë me statistikën, i ka fryrë ato. Ne po vuajmë tani pasojat e disa historive, që kanë ndodhur vite më parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord? Duhet bërë gradualisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, koha e statistikave në funksion të sukseseve ka mbaruar. Të paktën jemi koshientë për këtë, por nga ana tjetër, duhet të fillojmë dhe të krijojmë një premisë të saktë. Nuk mund të gjykojmë dot mbi masat dhe mbi efektet.

E dyta, edhe për imputet bujqësore, unë jam te mbështetësit e kësaj, por kam një problem me gjurmueshmërinë dhe me track-trace-in, me sistemin që duhet implementuar nga hyrja deri te dyqani i vogël, ku shiten produktet.

Do ta sjell më pas në vëmendje, por kisha këtë, merakun e të dhënave.

Mund të vijoni tani!

Ilir Beqaj – Kam një pyetje dhe një konstatim në fund, zoti Ministër, në lidhje skuadrën, që kemi angazhuar për projektin “100 fshatrat”. Ndoshta procesi i parë është në përfundim, por të paktën unë kam të vetmin informacion nga ajo çfarë u prezantua në Shishtavec.

Unë kam përshtypjen se ajo gjë nuk ka qenë vetëm punë arkitektësh. Gjëja që nuk më pëlqeu nga prezantimi është që në fund të fundit, nuk arritën të na thonë nëse ecin në atë model optimist zhvillimi. A do të rriten ndonjë çikë punësimi dhe të ardhurat? Unë për atë qëllim e bëj. Ju ishit vetë. Ata ishin marrë me atë se si pasqyrohet aktiviteti i Shishtavecit edhe në Instagram, por kam përshtypjen se aty duhet edhe në dimension ekonomisti, edhe pak histori etnografi. Mund të vijnë edhe arkitektë, por duhet të ketë një gërshetim më të mirë.

Të paktën me sa pashë për Shishtavecën, ka në specifikë se qarku i Kukësit filloi pak më vonë. Të tjerët mund të kenë avancuar më shumë, mund të kenë vënë produkte shumë më të plota dhe mund të jetë ezauruar edhe kjo që po kërkoj unë. Ata mund të ishin vetëm me ekspeditën e parë dhe nuk e ka bërë akoma ekspeditën e dytë qarku i Kukësi, se u vonua. Them se duhet bërë më e larmishme skuadra dhe mendoj se nuk është vetëm çështje arkitektësh.

Kisha edhe një pyetje: Sa prisni ta realizoni këtë vit fondin për subvencionet, që kishit në janar? Në mos gabo, ka qenë diku te 2,7 miliardë lekë.

Eduard Shalsi – Meqenëse jemi këtu, siç e thanë edhe kolegët e tjerë, parashikuam një buxhet që ishte më i larti vitin që kaloi, i cili rezulton (dhe ju duhet të përgjigjeni), se nuk është shfrytëzuar sa duhet. Masave që ne parashikuam a u është bërë një analizë e mirëfilltë, në mënyrë që këtë vit të dihet a do të funksionojë?

Pse nuk funksionoi gjatë këtij viti dhe çfarë garancie kemi, që kjo do të funksionojë në vitin që vjen?

Ka një ide që për shumicën e fshatarëve, nuk ishte ajo që kërkonin.

E dyta, disa kërkesa, siç ishte ajo e sigurimeve të fshatarëve, nuk mund të funksionojë dhe, për sa kohë është një kriter, nuk kemi [‘presim as për vitin 2019, nëse do të vlejë si kriter.

Pra, dua një analizë të asaj që ka ndodhur dhe të asaj që pritet të ndodhë në vitin 2019.

Urdhëroni, zoti Ministër!

Niko Peleshi – Kam një grafikë tjetër, që nuk është shumë politike. Nuk është sekret. Është thjesht një lloj skematizimi i realitetit. Prodhimi bujqësor shqiptar në vlerë është 2 miliardë e 300 milionë euro. Nga kjo, prodhimet bujqësore që eksportohen kanë vlerën 100 milionë euro.

Bujqësia që subvencionohet, është 20 milionë euro. Kjo është skema jonë.

Në numër fermerësh...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Po e përdor duke i qëndruar të njëjtit përcaktim, kur them “bujqësia” nënkuptoj prodhimin bujqësor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po të doni e saktësoj, por besoj se konvencion është, kuptohemi.

Ilir Beqaj – Ju mund të thoni se ky 20-milionësh i përket një prodhimi jo më shumë se 50-60 milionë gjithsej. Pra, nuk subvencionohet 100% për atë prodhimin që jep ai.

Niko Peleshi – Ne subvencionojmë 20 milionë euro për bujqësinë. Në numër fermerësh është për rreth 3000 fermerë, që do të thotë më pak se 1% e fermerëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eksportet bujqësore. Po ta bëjmë me grafik, e kemi këtu. *(shpjegon grafikun)*

Këtu paraqitet e gjithë bujqësia shqiptare. Ngjyra e verdhë paraqet pjesën që subvencionojmë. Nuk ka rëndësi nëse e themi apo jo, por nuk ka subvencionuar më shumë

ndonjë qeveri para qeverisë sonë. Ne e kemi 3-4-fishuar subvencionimin në krahasim me qeverisjen e PD-së.

Të rrimë shtrembër dhe të flasim drejt, kjo është situata sot. Ngjyra jeshile në grafik, paraqet eksportet bujqësore. Ngjyra e kuqe në grafik, paraqet bujqësinë që nuk subvencionohet, që prodhon për tregun vendas, por shihni se sa e rëndësishme është. Pjesa më e madhe, pjesa e luanit është bujqësia, që përbëhet nga fermerët që kanë pak tokë, që prodhojnë pak prodhime, të cilat i shesin në rrugën nacionale, në markete, te tregjet e qyteteve, por në fakt, gjithnjë e më shumë duke u rritur, po zëvendësojnë importet dhe po zënë një peshë kaq të madhe në totalin e bujqësisë. Kjo është arsyeja pse unë e bëra që në fillim, ndarjen në bujqësi komerciale dhe në bujqësi të fermave të vogla, sepse të themi të vërtetën, deri dje ka pasur zero politika për këtë të fundit, që paraqitet me ngjyrë të kuqe.

Nuk i mbështesim fare këta. Për këta, si të ekzistojnë qeveria dhe Ministria e Bujqësisë, si të mos ekzistojnë, është e njëjta gjë. Këta nuk kanë ndjerë asgjë.

Cilat janë formulat, që po mbështesim këta tani?

Unë përmenda, pa dashur të zgjatem shumë, diversifikimin e ekonomisë. Ne vërtet nuk i japim gjë një fermeri, i cili ka një tokë të vogël bujqësore në fshat dhe që prodhon pak për vete dhe pak për të shitur te rruga nacionale apo te tregu, por nëse i krijojmë mundësinë që përmes agroturizmit të ketë tani një treg afër fshatit, ai e shet tani prodhimin shumë më shtrenjtë.

E marrim gjithmonë si shembull. Në Fishtë të Lezhës fermerët e 3 fshatrave që prodhojnë për agroturizmin “Mrizi i zanave”, natyrisht e shesin 3-fish, krahasuar me çmimin që do ta shisnin te rruga nacionale. Ky është një lloj diversifikimi i ekonomisë. Një agroturizëm e ndryshon komplet lojën në fshat, për sa i përket nivelit të punësimit, sepse pothuajse të gjithë aty janë të punësuar në fermën e tyre, të vetëpunësuar realisht, por edhe të ardhurat rriten.

Prodhimet tradicionale, prodhimet tipike të zonave, nuk ka familje fermerësh që nuk i bën. Zahiretë duhet t’i nxjerrim nga qilarët në dritën e tregut. Këtë jemi duke bërë ne tani.

Këtu jam për t’u përgjigjur, se çfarë po bëjmë konkretisht, nuk jam për të bërë filozofi. E vërteta është që ne besojmë te potenciali i prodhimeve tradicionale të zonës. Nëse arrijmë t’i standardizojmë me disa procedura më të thjeshtuara, jo me standarde industriale, që nuk i arrijmë dot kurrë, dhe për këtë kemi bërë ligjin e prodhimeve tipike, dhe duke ndërtuar kanalet e tregut, ata mund t’i shesin me çmim disafish më të lartë. Një prodhim zahireje mund të shitet pesëfish apo gjashtëfish më shtrenjtë nëse arrijmë ta marketojmë siç duhet në treg. Ndryshe, e gjithë bujqësia, e shënuar me ngjyrë të kuqe në grafik, nuk merr gjë.

Këtu fillon përgjigja e pyetjes pse ne nuk kemi një regjistër, siç e kanë vendet më të zhvilluara, të fermës shqiptare. Regjistri nuk është çështje fondesh apo e një fotografimi që e bën vetëm një herë, problemi më i madh është si ta mbash të përditësuar me informacion. Pra, çdo vit situata në territor ndryshon dhe kjo duhet të pasqyrohet në regjistër. Ti mund të sigurosh disa milionë euro për të bërë një fotografim të situatës në të gjithë Shqipërinë, një census apo një verifikim fizik të situatës së fermave shqiptare, llojit të prodhimit, sipërfaqes së punuar e të tjera, por vitin tjetër nuk mund të investosh përsëri miliona euro për të bërë të njëjtën gjë. Duhet të gjendet një sistem që funksionon vetë. Cili është sistemi që funksionon vetë në vendet e tjera e zhvilluara? Janë pagesat direkte. Nuk ka fermer që nuk merr sadopak mbështetje financiare. Duke qenë se merr atë subvencion, ai është i detyruar ta apdejtojë informacionin te zyra përkatëse, ndryshe nuk merr e subvencionin. Pra, e kanë të lidhur me subvencionin. Kjo është arsyeja pse disa vende, që nuk janë më të zhvilluara se ne, kanë shifra më të larta subvencioni. Kryesisht e bëjnë për të mbajtur të formalizuar dhe të regjistruar bujqësinë. Nëse kjo është qasja e duhur, ky është një diskutim tjetër.

Në raport me buxhetin apo mundësitë që ka ky vend, unë mendoj se ne e mbështesim shumë bujqësinë. Nëse tullumbacia e subvencioneve fryhet dhe thërrmohet në çdo fermë bujqësore, nuk mendoj se ka efektivitet. Pra, nuk jam për modelin e disa vendeve, që shpeshherë opozita i merr si karshillëk ndaj nesh për mbështetje financiare.

Mendoj se jemi në rrugën e drejtë, ndaj dhe bujqësia shqiptare po ecën vitet e fundit me hapa shumë të mirë, eksportet po rriten me një ritëm shumë të lartë, por disa efekte anësore të rrugës që kemi zgjedhur duhet t'i ndaj me ju. Regjistri është një nga çështjet që ne akoma nuk e kemi zgjidhur, por ama kemi gati për të filluar një projekt me mbështetjen e Koperacionit Italian, i bllokuar për shkak të një arbitrazhi deri para 2-3 javëve, i cili do të bëhet aktiv në javët që pasojnë. Pjesë e këtij programi prej 20 milionë eurosh është edhe regjistri i fermës në vlerën 5 milionë euro, së bashku me disa softuerë të tjerë, por edhe me asistencën teknike të nevojshme dhe pajisjet e nevojshme për AZHBR-në për të ndërtuar hartën e fermave për të kompletuar regjistrin e fermës. Pra, e gjitha është 5 milionë euro financim i garantuar, që tani do të fillojë të aktivizohet. Jemi duke biseduar për ngritjen e PMU-së, sepse projekti ishte i ngrirë prej disa kohësh për shkak të arbitrazhit dhe do të fillojmë ta ndërtojmë.

Ngelet përsëri e hapur sfida për përditësimin e regjistrit. Pak rëndësi ka nëse kemi 300 apo 350 mijë fermerë, por fermerë me Nipt nuk kemi më shumë se 40 mijë dhe nga këta, vetëm 11 mijë fermerë përfitojnë nga rimbursimi i TVSH-së. Pra, 11 mijë fermerë marrin rimbursim TVSH-je përmes grumbulluesve. Këtu u ngrit pyetja nëse fermerët e marrin

realisht rimbursimin e TVSH-së. Në fakt, në praktikë nuk funksionon ashtu siç thuhet me fjalë.

Andrea Marto – Nga i keni nxjerrë këta 11 mijë?

Niko Peleshi – Nga të dhënat e tatim-taksave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj - Grumbulluesi thotë që këtyre ua kam ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ajo bëhet mbi bazën e autofaturës së grumbulluesit. Grumbulluesi plotëson një autofaturë në emrin Niko Peleshi.

Andrea Marto - Është normale, sepse ai e merr prodhimin nga dikush. E mban për vete apo ia jep ... ?

Niko Peleshi – Do jua them tani. Deri tani sqarova nga i kemi gjetur 11 mijë?

Në praktikë nuk funksion siç e themi me fjalë, pra, që grumbulluesi bën autofaturën, merr rimbursimin e TVSH-së nga shteti dhe pastaj shkon ua shpërndan fermerëve. Në praktikë nuk funksionon në këtë mënyrë në shumicën dërrmuese, por është pjesë e marrëveshjes që ai bën me fermerin kur e blen. Duke qenë se unë jam fermer me Nipt, unë kam një tjetër fuqi negociuese kur shes prodhimin. Jam fermer me Nipt dhe e di që ti si grumbullues e merr TVSH-në mbrapsht. Irfanit ia bleve mandarinat me 400 lekë, por nga unë e di që merr para mbrapsht, ndaj mua do të ma blesh me një çmim më të lartë. Edhe kjo nuk funksionon perfekt në praktikë, sepse tregu ka dinamikë. Duke qenë se këta janë 11 mijë fermerë, krahasuar me 300 mijë fermerë që ka Shqipëria, çmimin nuk e vendosin fermerët që kanë këtë fuqi negociuese të TVSH-së së rimbursuar, por e vendos shumica, këta që nuk janë fare të regjistruar dhe nuk marrin fare TVSH mbrapsht. Ata dalin në treg me prodhimin e tyre dhe vendosin çmimin. Me atë çmim shesin edhe të tjerët që përfitojnë rimbursim. Për këtë arsye, duhet të bëjmë çmos që ta heqim TVSH-në e imputeve bujqësore, herët ose vonë, por të mos e prekim TVSH-në e rimbursuar për fermerët, sepse do të dëmtonte eksportet dhe grumbulluesin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E mira dihet, por mundësitë nuk janë të pafundme. Nëse do të na duhet të bëjmë një *trade off* ndërmjet TVSH-së së rimbursuar dhe heqjes së TVSH-së së imputeve bujqësore, do të anonim më tepër të heqja e TVSH-së së imputeve bujqësore. Heqja e TVSH-së për imputet bujqësore do të ishte masa e parë kuptimplote e një qeverie shqiptare që prek çdo fermer. Heqja e TVSH-së së imputeve bujqësore do të ishte masa e parë e një qeverie shqiptare në 30 vjet që prek çdo fermer, si atë fermer që ka 1 dynym ashtu edhe fermën e madhe komerciale,

sepse të gjithë, në mënyrë proporcionale kuptohet, përdorin inpute bujqësore dhe do të përfitonin nga ulja e çmimit të imputeve bujqësore. Ngelemi te ky angazhim, por do ta kemi të mundur brenda këtij buxheti, apo jo, është pjesë e diskutimeve.

Siç edhe ju jeni në dijeni, dua ta sjell edhe njëherë këtu vullnetin dhe iniciativën e Kryeministrit për të bërë çmos që të ndërmarrim hapa edhe me këtë buxhet për heqjen e TVSH-së së imputeve bujqësore mundësisht që këtë vit.

Ilir Beqaj – Sa është vlera e TVSH-së që kthehet në vit?

Niko Peleshi – 16 milionë euro.

Ilir Beqaj – Do të thotë që përfaqëson një prodhim 90 milionësh.

Niko Peleshi – Pothuajse është e gjitha TVSH e eksportit.

Ilir Beqaj - Zoti Ministër, unë e kuptova arsyetimin e grafikut të dytë, por do të polemizoj pak, sepse ajo ishte pak e ekzagjeruar. Ai është subvencion, jo bujqësi e subvencionuar. Nëse këto vite ne e paskemi lënë bujqësinë në atë gjendje, i bie që paskemi investuar kot për vaditjen.

Niko Peleshi – Unë nuk e thashë atë. Nuk arrita atje.

Ilir Beqaj – Ai grafik tregon që i gjithë 90%-i është lënë jetim. Nëse është kështu, atëherë paskemi investuar kot për vaditje.

Niko Peleshi – E kisha në raport me mbështetjen financiare, që të mos e keqinterpretojmë. E thashë vetë që në fillim që kjo mund të keqinterpretohet.

Ilir Beqaj – Aty ishte vlera e prodhuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ishte 2,2 miliardë.

Nëse nga 120 shkuam në 225, do të thotë që të paktën një të tretës së fermerëve u kemi shkuar fermë më fermë me këto 105 mijë hektarë më shumë. Nuk kemi qenë selektiv.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur e bëjmë përmirësimin e vaditjes, uji shkon edhe te fermeri me nipt edhe tek ai pa Nipt. Nuk mund të themi që nuk kemi bërë politika masive. E kisha opinion dhe nuk pres ndonjë përgjigje, sepse kemi pikëpamje ...

Niko Peleshi – Unë do të përgjigjem, sepse e thashë vetë që ky grafik është i keqinterpretueshëm dhe, në fakt, këtu u keqinterpretua.

Kështu siç u tha, duket si jopolitik. Grafiku nuk synon të tregojë projektet tona të ujitje-kullimit dhe mbështetjet indirekte që ne i bëjmë bujqësisë, por synon të tregojë çfarë mbështesim ne drejtpërdrejt. Po, bujqësia e subvencionuar është 20 milionë euro, siç ju thashë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Subvencioni 20 milion euro nuk është subvencioni në bujqësi, por subvencioni për zhvillimin rural.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjysma.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Masa që do të kishte ndikimin më të madh në koston e prodhimit bujqësor është heqja e TVSH-së, sepse, sipas studimit që ne kemi bërë së fundmi në bashkëpunim me një organizatë tjetër, inputet bujqësore zënë 40-55% të koston të prodhimit bujqësor. Në një kilogram domate, 40- 50% e vlerës (varet sipas kulturave), është kosto e imputeve bujqësore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kosto e imputeve bujqësore: fara, fidani, ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

40-55% me kartela kostoje

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pjesa tjetër është fuqia punëtore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk po diskutojmë saktësinë e studimit.

Ne kemi bërë një studim, kurse ju e merrni me mend. Studimi tregon se 40-55% e koston së prodhimeve bujqësore janë inputet bujqësore. Lehtësimi i TVSH-së së imputeve bujqësore sjell reduktimin në gjysmën e koston.

E dyta, më pyetët sa shkon uji në parcelë nga investimet e mëdha që ne kemi bërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbaroj mendimin.

Pyetja ishte nëse ka sjellë apo jo rezultate ujitja dhe si ka mundësi që nuk është shtuar prodhimi e të tjera.

Së pari, të dhënat administrative të bujqësisë lënë shumë për të dëshiruar. Trashëguam një metodologji të statistikave bujqësore bazuar tek të dhënat administrative, që përpunohen nga drejtoritë e bujqësisë dhe jo nga INSTAT-i, e cila kishte shumë probleme. Censusi i bërë nga INSTAT-i del 40% më i ulët se sa të dhënat administrative. Nëse duhet t'i besojmë censusit apo të dhënave administrative, duke pasur parasysh që bëjmë fjalë për një sektor shumë informal, ka plot pikëpyetje për të dhënat e censusit.

Kur një fermeri i shkon një nëpunës i shtetit për t'i marrë të dhënat për fermën e vet, ai heziton të thotë të vërtetën. Pra, kjo është sfidë, që sado ta zbukurojmë, ngelet ashtu siç është. Kemi shumë punë për të bërë për të shkuar drejt statistikave të sakta bujqësore. Këtë sfidë e kanë edhe vende shumë të zhvilluara dhe vende anëtare të Bashkimit Europian, imagjino Shqipëria.

Pra, siç e thatë edhe ju, duhet bërë në mënyrë graduale korrektimi i një trashëgimie të së kaluarës, ku të dhënat administrative bujqësore prodhoheshin nga zyrat, siç prodhohen edhe sot, le ta themi, nuk është se ndryshon me urdhër të peshkut, mirëpo me një metodologji, e cila lë shumë për të dëshiruar dhe ka shumë pikëpyetje.

Pra, të mos e ndërtojmë gjithë diskutimin bazuar tek të dhënat administrative, kur e dimë se edhe aty kemi probleme. Gjithsesi, dua të them një fakt: kemi bërë projekte e investime të mëdha në ujitje e kullim, por i gjithë sistemi i ujitje-kullimit është i ndarë mes qeverisë qendrore dhe qeverisë vendore. Ne kemi kanalet kryesore, kanalet e dyta i ka qeveria vendore, ndërsa kanalet e treta i ka fermeri.

Që ne të marrim 100 % efektivitet të investimit të bërë në kanalet kryesore, duhet të presim që investimi të shkojë deri në fund. Pra, duhet të presim që edhe bashkitë të bëjnë rikonstrukcionin e kanaleve të dyta, duhet të presim që edhe fermerët të ndërgjegjësohen, të bëhen bashkë, të investojnë te tubi apo te kanali tretësor, për ta çuar ujin në parcelë.

Pra, jemi në proces. Padyshim, jemi shumë krenarë që në shumë zona të Shqipërisë kemi bërë pjesën e luanit, pjesën më të madhe, kemi dyfishuar sipërfaqen e vendosur nën ujë apo potencialisht të vendosshme nën ujë, sepse kemi bërë magjistralet kryesore, kemi bërë kanalet kryesore. tani çuarja deri te parcela, deri te çdo parcelë e fermerit, natyrisht që është detyrim i bashkisë dhe i fermerit, por është një gjë shumë më e vogël.

Para pak ditësh isha në Divjakë dhe pashë se bashkia atje po bënte një punë të shkëlqyer me kanalet dytësore, e madje po mbështet fermerët edhe në kanalet tretësore, Vizitova ferma, në të cilat vetë fermerët kanë investuar, jo te kanali, por te tubi, i cili e çon ujin te parcela. Pastaj ka bërë shpërndarjen e vaditjes në formë shiu apo të vaditjes me pika në parcelën e vet. Jam i sigurt se tani, këto modele do të fillojnë të replikohen nga të gjithë fermerët, dhe vetëm kur t'i shkojmë në fund, atëherë mund të flasim për matjen e rezultatit apo të efektivitetit që ka pasur ky investim. Kjo është të rrimë shtrembër e të flasim drejt, pa e mbuluar diellin me gisht. Kjo është e vërteta.

Investimi i bërë është shumë i rëndësishëm, por i paçuar deri në fund, për sa kohë që institucionet e tjera, bashki dhe fermerë, të kenë bërë pjesën e tyre.

Ky është shpjegimi për pyetjen tuaj lidhur me ujitjen, me çështjen e regjistrit, të dhënave administrative, INSTAT-in. Numri i fermerëve dhe sipërfaqja e punuar janë pjesë e problematike. Me letra, sipërfaqja e punuar na rezultojnë 50 mijë hektarë. Numri i fermerëve rezulton 350 mijë...

Eduard Shalsi – Si, 50 mijë hektarë?!

Niko Peleshi – 500 mijë hektarë sipërfaqja e punuar. 350 mijë numri i fermerëve. Se sa përputhet me realitetin, kjo është pjesë e korrektimeve që vijnë përmes proceseve që përmenda.

Për sa i përket realizimit të...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E gjithë sipërfaqja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – 420 e ke të fundit. 612 e ke. E di për çfarë diferencash flasim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të raportuara zyrtarisht. Siç i keni ju në këtë komision, kështu kanë ardhur edhe nga INSTAT-i. Flasim nga 410 mijë hektarë deri në 630 mijë hektarë. Ky është marzhi i gabimit. 500-qindëshja është e fundit që po dëgjojmë.

Niko Peleshi – Ne kemi 1 milionë diferencën në njerëz, nga censusi te regjistrat.

Eduard Shalsi – Pse 1 milionë? Jo, jo. Si e paskemi 1 milion?

Niko Peleshi – Po mirë, 600 mijë.

Eduard Shalsi – As 600 mijë.

Niko Peleshi – Po sa e kemi, sa?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se mund ta kemi më shumë se 1 milion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Jo, zoti Rakipi. Ma thuaj pak, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, more jo, si qenka kështu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Edhe fermerët mund të jenë në emigracion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka qenë 700 mijë hektarë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – O Rakip, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, një sekondë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Mbi atë tokë janë bërë qytete e fshatra të reja. Mbi atë tokë është bërë një qytet më i madh se qyteti im.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një sekondë, një sekondë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Po diferencat janë të kuptueshme nga çfarë ka ndodhur në Shqipëri. 450 mijë ndërtime pa leje.

Eduard Shalsi – Po pra, po.

Niko Peleshi – Pjesa më e madhe mbi tokë bujqësore. _Pra, ka ndryshime sespe është pushtuar tokë bujqësore.

Eduard Shalsi – Absolutisht. Puna është se do të vendosim një afat, për të marrë vesh, mbi një marzh gabimi 5 %, se sa është sipërfaqja e tokës bujqësore. Është bërë një fotografim satelitor. Unë nuk e di, është bërë një ortofoto shumë e detajuar, domethënë. Po bëjmë inventar pyjesh. Kemi bërë census njerëzish. Sot që flasim problemi është madhor. Them: do të japim një të dhënë, që është plus minus 5 % apo do të japim një të dhënë që është plus minus 40% - 50 %?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

O Rakip, një sekondë! Çfarë po themi, se s'po kuptojmë, s;po marrim vesh. Pra, nuk dimë sa njerëz kemi, kjo do të thotë se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

O Rakip, është njësoj sikur të ët thuhet ty, duke të parë: më dukesh si 80 vjeç, ose më dukesh si 30 vjeç.

Për këtë lloj difference po flasim tani. kemi raporte zyrtare për 410. A ishit në Bruksel? Doli pra, doli si problem, se do të dalë nesër për negociatat. Pra, ka ardhur koha të vendosim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë, meraku ynë është se duhet të vendosim disa statistika, të cilat mund të mos jenë të sakta, por të jenë me një marzh gabimi 5 ose 10, po jo sipërfaqja e tokës bujqësore të jetë 400 mijë, 500 mijë, 630 mijë. Ky është shqetësimi im.

Niko Peleshi – 410 mijë, 420 mijë në fakt, është sipërfaqja e asaj që quhet tokë – arë. 80 mijë të tjera janë vreshtari dhe pemëtore. Prandaj, mbase keni dëgjuar 410-ën, por mund t'i jeni referuar vetëm tokës – arë.

Eduard Shalsi – Jo, jo, bashkë me vreshtarinë...

Niko Peleshi – Toka - arë 420, plus 80 mijë pemëtore e vreshta, bëjnë 500 mijë.

Eduard Shalsi – Ja ku është Irfani, i cili do të na i nxjerrë të gjitha sa janë thënë këtu për pesë vjetët e fundit. Të deklaruar në komision, e ke 410 mijë, bashkë me vreshtari e pemëtore.

Nejse. Çështja është se duhet vendosur një rregull, që ta dimë për çfarë flasim.

Niko Peleshi – Unë e thashë vetë se të dhënat bujqësore...

Eduard Shalsi – Dakord!

Jemi në limitet e kohës, ju lutem! Andrea, Tatiana. Ka ndonjë tjetër pastaj? Eglantina.

Andrea Marto – Së pari, kam një shqetësim lidhur me regjistrimin ose marrjen e titujve të pronësisë të tokës bujqësore, që u përmend nga zoti ministër, kur foli për problemet nëpër zonat ku tokat nuk janë ndarë sipas ligjit nr. 7501. Ka probleme dhe nuk ka ecur procesi mbarë as në zonat ku tokat janë ndarë sipas 7501-shit.

Vitin e kaluar, ne bëmë një shtyrje afati, duke e çuar procesin deri më datë 31. 12. 2018. Tani, për shkak se ish-komisionet nuk e anë ndarë saktë, për shkak se bashkitë ishin të paimteresuara dhe nuk kanë personelin e duhur për të realizuar procesin, unë them që urgjentisht, brenda muajit dhjetor, duhet ta shtyjme këtë afat.

Kjo ishte gjëja e parë që kisha.

E dyta, një nga problemet më të mëdha që kemi ne dhe që do të dalin kur të bëhen saktësimi tokës-arë, i tokës bujqësore të punueshme, është erozioni. Vitet e fundit Shqipëria dhe fermerët kanë humbur me mijëra hektarë tokë për shkak të mosdisiplinimit të lumenjve. A keni ndonjë program, ndonjë projekt për ta parë këtë çështje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë! Tani, përveç ndërtimeve pa leje, që i zhvatën këtij vendi me mijëra e mijëra hektarë tokë buke, tokë të punueshme, erozioni vijon të jetë një problem shumë i madh. Mendoj se kjo duhet të jetë një ndër përparësitë e ministrisë suaj.

E treta që kam, është një çështje konkrete, të cilën e kam shtruar edhe vitin e kaluar. Në Jug është një fushë mjaft e pasur dhe pjellore, fusha e Vurgut. Ajo ka pasur një kanal vaditës në vetvete të shkëlqyer, të quajtur Thoma Filipeo. A është në programet e qeverisë rikonstruksioni i këtij kanali, që të bëhet efektiv?

Ju faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Ministër, meqenëse jemi në fund, a mund t'i marrësh të tria pyetjet e pastaj të përgjigjesh?

Tatjana, të lutem.

Tatiana Nurçe – Faleminderit, zoti Shalsi!

Faleminderit, zoti Ministër i Bujqësisë!

Unë vi nga qyteti i Lushnjës, bashki në të cilën bujqësia është një nga sektorët kryesorë, duke kontribuar në prodhimin bujqësor dhe blegtoral jo vetëm në këtë zonë, por edhe në mjaft bashki të tjera në shkallë në vendi, duke përbërë alternativën kryesore të të ardhurave dhe të zënies me punë të njerëzve në këtë zonë. Bashkia ka resurse të larmishme, sipërfaqe toke në fushë, në kodër, basene ujore, pyje, kullota dhe kushte klimatike tokësore mjaft të favorshme. Nga takimet që kam bërë me fermerët kam marrë disa mendime për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë në rrethin e Lushnjës për vitin 2019.

Në infrastrukturë, ndërtimi i rrugëve rurale, ndërtimi i parcelave dhe investimi për transportin e produkteve që ata duan të nxjerrin në rrugë; vendosja e rrjetit elektrik dhe shtrirja e këtij rrjeti pranë investimeve, përmirësimi i rrjetit ujitës, rehabilitimi i shtimit të ujit për çdo parcelë, përmirësimi i rrjetit kullues, rehabilitimi i rrjetit kullues në zonat ku kanë ndodhur përmbytje, ndërtimi i një terminali, që është si një zyrë doganore, pasi fermerët e Lushnjës kalimin e produktit në doganë e bëjnë në Fier dhe realisht, po të kishte një zyrë doganore në qytetin e Lushnjës, do t'ua lehtësonte punën, edhe për faktin që për të vajtur në Qafë-Thanë duhet të kalosh nga Lushnja, ndoshta mund të duket pak si çudi, por kjo gjë ka dalë nga fermerët.

Mbështetja që i duhet dhënë funksionit të laboratorit të analizave fiziko-kimike për prodhimet bujqësore; investimi për pajisjen e laboratorit dhe i reagentëve për kryerjen e analizave për mbajtjen e nitriteve dhe të mbetjeve; nxitja e aktivitetit të industrisë agropërpunuese, dhe nuk e di, nëse keni menduar për ndonjë shkollë të formimit profesional për baxhoxhinjtë apo për ata njerëz për të cilët tregu ka shumë nevojë, si dhe për përpunimin e fruta-perimeve që ngelin stok në qytetin e Lushnjës, gjë, të cilën ju e dini shumë mirë.

Mbështetje për konsolidimin e tokës bujqësore, aktualisht toka është copëzuar, rripa-riipa, si dhe në lidhje me digat e rezervuarëve që ndodhen në Lushnjë, pasi atje duhet një impenjim maksimal për ruajtjen dhe riparimin e tyre.

Dua t'ju them disa gjëra për AZHPR-në, për Agropikën, për skemat e subvencioneve në bujqësi dhe blegtori. Dalja e një vendimi të qeverisë sa më shpejt të jetë e mundur për subvencionet, do të bëjë të mundur promovimin dhe informimin e fermerëve për të aplikuar pranë agropikave për mbledhjen e pemëve frutore, siç janë agrumet, vreshtat, ulliri dhe shega,

për skemën e ujitjes me pika; të subvencionohen fermerët dhe kultivimi intensiv, por edhe tradicional në skemën e bostaneve të bëhet zëvendësimi i plasmanit e të tjera, ndërsa në skemën e matrikullimit dhe të lindjeve të reja, të subvencioneve matrikullimi i tufës bazë.

Në aspektin financiar të ulet TVSH-ja për imputet bujqësore në nivelin e rajonit, por fermerët kanë edhe një ide tjetër sa i takon çmimit të naftës që përdoret në bujqësi dhe blegtori. Moderimi i TVSH-së për pikat e grumbullimit të fruta-perimeve dhe sa i takon fushës së edukimit është rikthimi i Universitetit Bujqësor, ashtu siç ka qenë, i cili me aq sa mbaj mend, vetëm 3 vjet ka funksionuar. Pra, kthimi i Universitetit Bujqësor në Lushnjë do të jetë pjesa më e rëndësishme dhe nderi më i madh që do t'i bëhet qytetit të Lushnjës dhe gjithë zonës.

Ne kemi shumë nevojë për specialistë bujqësie, specialistë blegtorie, si dhe për pjesën tjetër për të cilën qyteti i Lushnjës nuk është aq i pasur, pra prania e Universitetit Bujqësor në këtë qytet, pasi të gjithë studentët shkojnë në Kamëz ose nëpër universitete të tjera. Pra, nëse realisht Universiteti Bujqësor do të ishte në qytetin e Lushnjës kjo do të krijonte një lehtësi të madhe ekonomike për gjithë qytetin dhe rajonin përreth tij.

Këto ishin pak a shumë disa prej gjërave që unë kam vërejtur nga takimet me fermerët dhe pak a shumë jua thashë sipas formës dhe mënyrës që ata i kanë shprehur. Realisht qyteti i Lushnjës ka pasur investime në bujqësi, por nuk e di se çfarë është planifikuar për vitin 2019, por shpresoj të jetë menduar mirë për qytetin e Lushnjës.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Leka.

Edmond Leka – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë doja të ngritja vetëm dy shqetësime të mëdha që kemi sa i takon zonës së Myzeqesë, zoti Ministër!

E para, doja t'ju pyesja se çfarë është menduar për përmbytjet në zonën e Myzeqesë, pasi dihet që vjet njësia administrative e Novoselës, e cila përfshin 8 fshatra pësoi një dëm të madh ekonomik nga përmbytjet në atë zonë. A janë marrë masa dhe a keni parashikuar të bëni ndërhyrje në lumin Vjosë për mbrojtjen e krahinës së Myzeqesë?

E dyta, ju keni qenë vetë në zonën e Orikumit dhe i keni vizituar të gjitha bizneset në atë zonë, por kam një shqetësim të madh sa i takon kënetës së Orikumit. Ajo është një sipërfaqe prej rreth 150 hektarësh, e cila është përmbytur për 15 vjet, një sipërfaqe që u shërbente rreth 100 familjeve në atë zonë dhe ka qenë e shquar për prodhimin e shalqirit. Të gjitha këto familje kanë pësuar një dëm të madh ekonomik, por shqetësimi më i madh për atë zonë janë pasojat që po krijon përmbytja dhe kënetat, sepse kjo është edhe një zonë turistike

në rrethin e Vlorës, ku shqetësim për këtë vit kanë qenë mushkonjat. A është parashikuar ndonjë gjë për këtë zonë? Gjithashtu, në këtë zonë ndodhet edhe një stacion pompash, që është jashtë përdorimit, i cili nuk përdoret prej shumë vitesh dhe ky stacion do t'i shërbente jo vetëm turizmit, por edhe bujqësisë.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Po, zoti Suli.

Rakip Suli – Faleminderit, kryetar!

Unë kisha një pyetje për ministrin. Ju, zoti Ministër, në fjalën tuaj prekët titujt e pronësisë për tokat bujqësore. Doja të dija se si ka qenë ecuria në këtë fushë deri tani? Me aq sa unë kuptova do të ketë një riorganizim të ri për pjesën e titujve të pronësisë të tokave bujqësore, pasi normalisht është mjaft i rëndësishëm edhe për faktin se nëse sot flasim për skemat që aplikohen nga ana financiare, baza dhe themeli janë titujt e pronësisë gjë që na çon drejt atyre gjërave që mund të realizohen krahas projekteve.

Eduard Shalsi – Po, zoti Draçi.

Ilir Ndraxhi – Kisha diçka shumë shkurt. Unë e mbështes fjalën e ministrit sa i takon heqjes së TVSH-së për imputet bujqësore, por kam vetëm një kërkesë. Çfarë do të bëhet për pastrimin e një kanali që kalon nga zona e Ndroqit, i cili përfshin pjesën më bujqësore të Bashkisë së Shijakut, për të cilin ka mbi 18 vjet që nuk është vënë dorë dhe është totalisht i bllokuar?

Eduard Shalsi – E përmbyll seancën e pyetjeve, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër, për prezantimin tuaj!

Unë kisha dy pyetje dhe do të doja që përgjigjet të ishin të shkurtra.

E para, lidhur me programin e IPARD-it, meqenëse e përmendët në prezantimin tuaj, që e rëndësishme është të përthithen të gjitha fondet. Unë kam parë që ju keni bërë një reklamë televizive, komplimente lidhur me këtë, sa i takon hapjes së tij. Do të doja të dija se çfarë do të bëhet konkretisht për rritjen e kapaciteteve, për mundësinë e informimit që vërtet të garantojmë që fondet të përthithen?

Sa i takon AZHBR-së ju na i keni përmendur, unë ju mbështes për shtimin e fondeve dhe besoj se do ta diskutojmë këtë gjë në komision dhe besoj se do t'ju mbështesim në këtë pikë.

Sa i takon sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit, u fol në prezantimin tuaj, por nga përgjigjet nuk morëm shumë informacion, prandaj do të doja të dija shkurtimisht

se çfarë do të bëhet ndryshe në 2019-n? A do të jenë konsumatorët shqiptarë më të sigurt? Çfarë do të kemi më të garantuar?

Gjithashtu, kam edhe një pyetje specifike, meqenëse flitet shumë për zonat rurale dhe kemi një pjesë të mirë të popullsisë atje. A ka ndonjë program apo projekt të veçantë për gratë në zonat rurale. Te këshillimi në relacion ju keni përcaktuar se do të trajnoni dhe do të informoni disa gra, por unë dua të di diçka më specifike: a keni programe apo projekte që i mbështesin në mënyrë specifike gratë në zonat rurale?

Eduard Shalsi – Atëherë, para se ministri t’u përgjigjet pyetjeve unë dua të përshëndes një mikun tonë, senatorin e mirënjohur holandez në sektorin e ujit, njëkohësisht edhe drejtor i një bordi shumë të rëndësishëm, zotin Schwabe, i cili po asiston në disa fusha.

I uroj mirëse ardhjen mysafirit tonë në punimet e këtij komisioni!

Sot kemi një seancë me ministrin e Bujqësisë, i cili po relaton.

Zoti Ministër, fjala për ju.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Gjithashtu, dua t’i bashkohem vlerësimit tuaj për senatorin, me të cilin kam pasur disa takime, një takim në Holandë dhe një takim në vizitën e tij të parë në Shqipëri. Sot në mëngjes kishim, gjithashtu, një bisedë të shkurtër, ku folëm për mundësinë e bashkëpunimit në të ardhmen e afërt për çështjen e përmytjeve. Ju të gjithë e dini që Holanda është kampione botërore për sa u përket çështjeve që lidhen me ujin dhe besoj se kemi shumë për të mësuar. Shpresojmë që do të konkretizojmë shumë shpejt një bashkëpunim me objektiva konkretë për këtë problematikë kaq sfiduese, që është në vendin tonë, siç është përmytja.

Këtu pati disa pyetje, në listën e gjatë të pyetjeve që kam unë për t’u përgjigjur lidhur me kërcënimin e lumenjve për përmytje në zona të caktuara që kanë dhe bujqësi të zhvilluar, siç është zona e Fierit, zona e Lushnjës, si dhe zona e Vlorës pjesërisht.

Zoti Andrea pyeti për dy ligjet që skadojnë në fund të këtij viti, ligji “Për plotësimin e AMTP-së” dhe ligji “Për verifikimin e ligjshmërisë së titujve të pronësisë”.

Në fakt, zoti Andrea, ne nuk kemi ndër mend ta shtyjmë afatin, ndonëse të dyja proceset nuk kanë përfunduar, por, siç ju thashë, në fillim kemi hartuar një ligj të ri “Për përfundimin e proceseve transitore”, që është pjesë e reformës sonë për pronën, dhe duam ta adresojmë. Pra, çështjet që do të mbarten nga mospërfundimi i procesit që shtrinin këto dy ligje do t’ia kalojmë Agjencisë së re të Trajtimit të Pronës dhe do t’i parashikojmë te ligji i ri “Për përfundimin e proceseve transitore”.

Ne kemi ecur mirë me plotësimin e titujve të pronësisë, por nuk është kjo pjesa më e madhe e problemit. Pra, problemi nuk janë fermerët, të cilët nuk kanë marrë titujt e pronësisë,

sepse ata janë 5%. Pra, rreth 5% e fermerëve në të gjithë Shqipërinë nuk kanë marrë, për arsye të ndryshme, tokën që u takon nga ligji nr. 7501. Për këtë kategori ligji, që skadon në fund të vitit “Për plotësimin titujve të pronësisë”, u krijon mundësi bashkive që t’i pajisin me AMTP.

Përsëri nuk kanë shkuar të gjithë që të aplikojnë, por ata që kanë bërë kërkesë dhe janë në proces për të marrë titullin e pronësisë janë rreth 6 apo 7 mijë fermerë nga 20 mijë që mund të jenë gjithsej, kurse pjesa tjetër, siç e thashë, do të trajtohet nga agjencia e re dhe nga ligji i ri.

Është e vërtetë ajo që thatë ju që ky problem nuk është vetëm në zonat ku nuk ka vepruar ligji nr. 7501, sepse, në fakt, ato zona janë shumë pak në raport me të tërën.

Gjithashtu, kemi edhe një problem me regjistrimin e AMTP-ve të lëshuara. Me të vërtetë pothuajse gjysma e AMTP-ve të lëshuara nuk janë regjistruar. Ju e dini se AMTP-ja është titulli i pronësisë, ndërkohë që nuk quhet tapi për sa kohë nuk është regjistruar në hipotekë. Vetëm 50% janë regjistruar, kurse 50% nuk janë regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme. Arsyet pse ky proces nuk ka përfunduar janë të shumta, lidhen edhe me vetë iniciativën e fermerit, por shpeshherë fermeri nuk ka çfarë të bëjë, sepse nuk e regjistron dot AMTP-në për arsye të hartave, për probleme të mbivendosjeve, për pasaktësi të hartës së hipotekës, për pasaktësi të titullit të pronësisë, pra të AMTP-së e të tjerë. Të gjitha këto problematikat, që lidhen me titujt e pronësisë, i kemi hartëzua, i kemi adresuar te ligji që përmenda dhe me ngritjen e institucionit të ri të trajtimit të pronës, që do të ketë brenda vetes pothuajse të gjitha zyrat që do të merren me titujt e pronësisë, ky proces do të marrë, për mendimin tim, shpejtësinë optimale, që do ta çojë drejt zgjidhjes brenda pak vitesh. Ashtu siç e kemi sot të strukturuar, ky proces mund të kalojë pa u zgjidhur edhe për shumë vjet të tjera.

Sot që flasim, unë e kam thënë vazhdimisht, kemi një paradoks, sepse harta e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Patundshme ka forcë ligjore, por është e pasaktë, ndërsa harta e saktë është harta që ka dalë nga fotografia ajrore e vitit 2015, me të cilin punon ALUIZNI, por kjo harta e saktë nuk ka forcë ligjore. Ky është paradoksi që kemi dhe që bëhet shkak për dhjetëra e mijëra konflikte gjyqësore ndërmjet atyre që posedojnë një titull pronësie. Të gjitha këto probleme i kemi hartëzuar dhe duhet t’u japim zgjidhje me ligjin e ri, që tani është në konsultim e sipër.

Ju përmendët problemin e erozionit, si dhe probleme të tjera që lidhen me përmbytjet, siç i përmendën edhe kolegët e tjerë. Të them të drejtën nuk është se kemi shumë fonde për të adresuar problematikën e përmbytjeve dhe të erozionit, sepse kërkojnë buxhete shumë të mëdha. Ne kemi një listë projektesh të parashikuara për këtë vit, mund të ndryshojnë plus-

minus, por këto janë pak a shumë. Ne parashikojmë ndërhyrje në lumin e Vjosës në zonën e Selenicës dhe të Ferrasit; po kryejmë ndërhyrje në urën e Mifolit, në bashkëpunim edhe me bashkinë, dhe aktualisht pothuajse jemi në përfundim në zonën e Vjosës; parashikojmë ndërhyrje në lumin e Kalasës në Delvinë; parashikojmë ndërhyrje në lumin Kseras në fshatin Vrisera në Gjirokastrë; parashikojmë ndërhyrje në lumin Buna në segmentin Pentar – Luarës; parashikojmë ndërhyrje në lumin Osum në fshatin Tapi dhe në Urën Vajgurore; parashikojmë ndërhyrje në lumin Devoll në thellimin e tij në fushën e Maliqit, si dhe sistemin e përroit të Draxhit në Kavajë, që do ta fillojmë këtë vit dhe do ta përfundojmë vitin e ardhshëm. Këto janë ndërhyrjet që ne mund t'i realizojmë me buxhetin që kemi për parandalimin e përmytjeve.

Ndërkohë, zoti Andrea, lajm pozitiv për kanalin e Vurgut është se e kemi pjesë të programit të projektit me Bankën Botërore në shifrën 53 milionë euro, ku përshihet edhe rezervuari i Janjerit. Edhe kjo është një vepër që lidhet me këtë rezervuar, apo jo.

Andrea Marto – Ju po flisni për kanalin Thoma Filipeu, por kjo është pjesë më vete.

Niko Peleshi – Nuk është kjo atje?

Andrea Marto – Jo, nuk është.

Niko Peleshi – Atëherë, kërkoj ndjesë, sepse nuk është pjesë e atij projekti, por do të shikojmë mundësinë e trajtimit. Të paktën rezervuari i Janjerit dhe skema që lidhet me të rreth 4500 hektarë në pjesën e Konispolit dhe Xarrës do të marrin investim brenda vitit që vjen.

Gjithashtu, kishte disa propozime për zonën e Lushnjës. Natyrisht, jo të gjitha lidhen me ne, por kanë lidhje me bujqësinë dhe kjo ka rëndësi. Rrugët e parcelave, mirëmbajta e digave dhe rezervuarëve janë përgjegjësi dhe kompetencë e pushtetit vendor, sepse janë decentralizuara.

Qeveria qendrore, pa dyshim, që nuk mund të mjaftohet vetëm me decentralizimin e funksioneve, por Ministria e Financave u ka shtuar buxhet në transfertën e pakushtëzuar. Pra, duke u rritur transfertat e pakushtëzuar bashkitë kanë mundësi të bëjnë më shumë punë në zonat rurale, jo vetëm në zonat urbane.

Shkolla e Mesme Bujqësore dhe universiteti janë investime që edhe ne i presim. Këto nuk kanë lidhje drejtpërsëdrejti me ministrinë tonë, por janë në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Arsimit, kështu që nuk mund të flas dot për to. Unë mund të flas për rëndësinë që ka arsimi profesional dhe arsimi i lartë i agronomëve dhe veterinerëve, sepse mosha mesatare e tyre është shumë e lartë, pavarësisht se vitet e fundit është rritur numri i studentëve, falë politikave të qeverisë, që shkojnë për agronomi dhe veterinar. Gjithashtu,

edhe bashkëpunimi ynë me Universitetin Bujqësor të Kazmës është rritur, por kjo mbetet një betejë e pafituar. Pra, ne nuk mund të themi ende se të rinjtë shkojnë njëloj me kënaqësi të studiojnë për agronomi apo veterinar, siç mund të shkojnë për degë të tjera dhe nuk ua kemi rikthyer ende prestigjin.

Kjo është sfidë dhe duhet të vazhdojmë. Nevoja është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëro?

Atëherë, edhe unë do t'i bashkohem propozimit tuaj për t'i thënë Ministrisë së Arsimit ta përfshijë në planet e saj hapjen e shkollës së mesme bujqësore, pse jo, mundësisht edhe të një fakulteti. Ne jemi pozitivë dhe jemi në një krah.

Konsolidimi i tokës bujqësore ngelet një sfidë për ne. Po e përmend shumë fjalën sfidë, por, në fakt, është e vërtetë që sektori me më shumë sfida është bujqësia. Në qoftë se ne nuk arrijmë dot sukses në konsolidimin e tokës bujqësore për të mbështetur fermën shqiptare, nuk kemi bërë gjë, le të thotë çfarë të dojë Beqaj! Ashtu si është sot toka e copëzuar, me atë 1-hektarëshin që ka në mesatare, i ndarë në 3-4 vende, çfarëdo të bëjmë ne, e kemi të pamundur. Sado të investojmë në veprat ujitëse dhe kulluese, për ta çuar ujin në çdo parcelë me kanalin e tretë apo me tubin në secilën prej parcelave të vogla, duhet një investim i madh nga fermeri, se ne nuk e bëjmë dot, sepse nuk është prona jonë, madje nuk është as e bashkisë, është e vetë fermerit, aq sa ai nuk e bën për 100 vjet. Atëherë, çfarë duhet bërë? Minimalisht, duhet konsoliduar toka, përmes shkëmbimeve apo politikave të tjera, që të paktën atë 1-hektarësh që ka, ta ketë në një vend dhe të rritet efienca e investimeve. Është një gjë ta çosh kanalin në një parcelë 1-hektarëshe dhe është një gjë tjetër ta çosh kanalin në 4 parcela nga 2 dynym e gjysmë, që të gjitha bëjnë një hektar, pra pothuajse katërfishohet vlera e investimit.

Konsolidimi i tokës ka rëndësi edhe për të rritur eficiencën e investimeve, për të krijuar atë që quhet ekonomi shkalle.

Çfarë po bëjmë? Jam i gatshëm të vij në një takim tjetër dhe të flasim gjerë e gjatë për këtë temë. Jemi duke punuar fort. Kemi disa propozime dhe ato janë jo shumë politike. Mbase do të vijë dita që të ketë një lloj qetësie politike në vend dhe ata, që sot janë në rrugë, do të vijnë këtu, madje jo vetëm për të bërë opozitën, por për të thënë se cilat janë disa reforma, që pavarësisht se ne jemi opozitë apo në pushtet, duhen bërë.

Reformat e tokës dhe konsolidimi i saj duhet t'i tejkalojnë agjendat tona politike. Duhet të marrim guximin të ndërmarrim disa politika, nisma, reforma, të cilat mund të na japin kosto afatshkurtër, por i japin vendit përfitim afatgjatë. Është kollaj të thuhet, por që të

bëhet, nuk kërkon vetëm qeverinë, por edhe opozitën, që të ulen bashkë për të punuar, jo për t'u grindur. Ky nuk është një leksion që duhet t'ia bëjmë vetes apo ju, por duhet ta thosha, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, po flisja për veten.

Për shembull, copëzimit i tokës bujqësore është ulëritës në vendin tonë. Duhet ta ndalojmë copëzimin e tokës. Si ndalohet kjo? Kjo ndalohet edhe me ligje. Nuk është kollaj të thuhet, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E shikon? Dole e para kundër. Sapo e regjistrove emrin e para kundër kësaj gjëje, sepse duket sikur na shkakton kosto. Në fakt, po vazhdoi të copëzohet toka...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në Danimarkë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam shumë i gatshëm të vij të flas për këtë temë gjerë e gjatë. Kemi disa ide, që janë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...shumë revolucionare dhe i japin përgjigje edhe kauzës që ju ngritët tani, pra e zgjidhin kauzën. Nuk janë shpikje, por janë ide të marra nga vendet e Bashkimit Europian, si, për shembull, Danimarka. Në Danimarkë, por edhe në Poloni dhe vende të tjera, megjithëse ferma mesatare është rreth 60 hektarë, e kanë të ndalur me ligj copëzimin e tokës, madje kanë edhe konceptin e trashëgimisë së kufizuar dhe nuk lejohet ta pjesëtosh tokën në 100 apo në shumë të tjerë, fëmijë apo ku di unë dhe ta shesësh copa-copa. Duhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka zgjidhje tjetër dhe nuk jemi ne ata që po e shpikin.

Andrea Marto – Zoti Ministër, nuk doja të bëja pyetje, por cili është defekti? U bënë disa kooperativa në Fier dhe të parët që vajtën nuk ishin ata që do t'i ndihmonin fermerët, por vajtën tatimorët, për t'i kërkuar si, qysh, çfarë prodhon, sa më jep dhe sa më takon mua.

Në qoftë se ...

Niko Peleshi – Unë e thashë edhe vetë që, pa bërë disa rregullime, që i bëjmë këtë vit, për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, ishte vërtet e vështirë të bindje fermerët të bëheshin bashkë, por tani që flasim e kemi zgjidhur.

Tani SHBB-të trajtohen sikur janë një fermer individual, pavarësisht se sa xhiro realizojnë. SHBB-të nuk paguajnë TVSH, nuk presin faturë. Ftuarën e pret grumbulluesi me

autofaturim, pra i kemi çliruar shumë nga ngarkesat, qoftë administrative dhe burokratike, qoftë financiare dhe fiskale. Gjithsesi...

Andrea Marto – Edhe kur vjen puna te subvencionet, u jepet përparësi.

Niko Peleshi – Teorikisht ose me letra ne u japim përparësi.

Çështja është se sa SHBB kemi, që të vijnë të aplikojnë, se sa binden dhe sa i tejkalojnë ata problemet e mendësisë dhe mentalitetit të së shkuarës, që të bëhen bashkë. Kjo është sfida jonë, është një shpirt që do të dalë nga ne, nuk kemi çfarë të bëjmë, por nuk është e thjeshtë të zbatohet.

Po e mbyll çështjen e konsolidimit, Tatjana, për të mos u zgjatur më tepër, por ju jap të drejtë që është problem i madh dhe nismat duhet të dalin nga ne...

Besnik Baraj – Është problematikë që nuk ezaurohet tani dhe me një përgjigje. Kjo është vërtet shumë komplekse.

Niko Peleshi- Duhet t'ju informoj që kemi disa procedime për ta adresuar çështjen e konsolidimit të tokës, që e kanë ngritur, me shumë të drejtë, fermerët. Nuk është faji juaj, nuk është as i fermerëve, por është një gjë që duhet zgjidhur edhe me mbështetjen tonë.

Dua të them vetëm që me mbështetjen e IPARD-it, skema kombëtare e mbështetjes ka një lloj problematike, që nuk duhet të mbivendoset me IPARD-in, pra çfarë mbështet IPARD-i nuk mund ta mbështesim dot me skemën kombëtare.

Ju përmendët disa masa. Jo të gjitha masat do të mund t'i mbështesim nga skema kombëtare, një pjesë do të mbështeten nga IPARD-i, çfarë mbetet jashtë do ta mbështesim ne. Pse e them këtë? Ju ftoj të na ndihmoni për të bindur fermerët të pajisen me NIPT-in. Ata duhet të formalizohen, në mënyrë që të kenë mundësi të aplikojnë te IPARD-i. Nuk ka më tolerime tani, nuk ka më zgjidhje për të përfituar mbështetje financiare, në qoftë se nuk je formal. Pra, le t'i nxisim fermerët së bashku, duke shfrytëzuar edhe këtë komunikim, që të pajisen sa më shpejt me NIPT, të marrin informacion për IPARD-in dhe skemën kombëtare dhe të aplikojnë për të përfituar.

Çështjen e kënetës së Orikumit, brenda problematikave të përmytjeve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, kemi në plan hidrovorin për vitin që vjen. Mbase hidrovori nuk e zgjidh gjithë problemin, por të paktën është ndërhyrja e parë që do të kryejmë këtë vit. Më tej, do të shohim.

Për kanalin e Shijakut, përsëri kam një lajm të mirë. Në qoftë se bëhet fjalë për Ndroq-Çallik, e kemi në planin e viti 2019 dhe e kemi parashikuar në buxhet për ta investuar.

Për titujt e pronësisë, fola.

Për sa i përket IPARD-it, zonja Gjermani ngriti pyetje se çfarë kemi bërë për të rritur përthithjen e IPARD-it. Aktualisht, me mbështetjen e GIZ-it, po trajnojmë konsulentët në të gjithë Shqipërinë, sepse, në fakt, ata janë thembra e Akilit. Në qoftë se konsulentët privatë në treg do të jenë të trajnuar, të kualifikuar dhe të aftë të asistojnë fermerët apo investitorët për të shkruar planet, projektet e tyre dhe aplikimet të IPARD-it, atëherë do të kemi aplikime të suksesshme, fituese dhe do të rritet norma e përthithjes. Pra, jemi në një proces të trajnimit të konsulentëve nga njëra anë dhe të punonjësve të ASHBR-së nga ana tjetër, si dhe të ekstensionistëve të ish-drejtorive të bujqësisë apo të agjencisë së ekstensionit që kemi sot, sepse edhe ata janë shumë të rëndësishëm, sidomos për pjesën e fermerëve. Ata janë në territor, kanë njohje personale, kanë mbulim personal, janë çdo ditë me fermerët dhe në qoftë se i këshillojnë drejt ata, mund të kemi aplikime fituese. Në qoftë se fermerët këshillohen gabim, shkalla e përthithjes do të ulet.

Jemi shumë të sfiduar, është e vërtetë, sepse kur shikojmë që, për shembull, Maqedonia në 10 vjet ka përthithur 15 % të IPARD-it, ndërkohë që ne këtë duhet ta përthithim në 1 vit, gjatë vitit që vjen, kuptohet se sa kritike është çështja, por po mundohemi ta adresojmë.

Për sa u përket grave që jetojnë në fshat... Nuk dua të flas gjatë për programin e 100 fshatrave, sepse ende nuk i kemi projektet e detajuara, si dhe nuk të flas në kohën e ardhme dëshirore të pakryer, megjithatë programi i 100 fshatrave nuk përmban vetëm pjesën *hard*, por edhe pjesën *soft*; kohezionin social, punën me grupe sociale. Përveç bujqësisë, gratë janë kategoria kryesore sociale që prodhojnë në fshat. Prodhimet tipike dalin nga duart e grave. Duke mbështetur prodhimet tipike, inkubatorët, punishtet e prodhimeve tipike dhe shumë hallka të tjera të këtij nënsektori apo të këtij sektori të ri që duam të krijojmë, indirekt kemi mbështetur gratë. Te skema kombëtare, por edhe te skema e IPARD-it kemi vendosur një bonus apo diskriminim pozitiv për gratë. Te skema e IPARD-it më shumë se 10% të pikëve i marrin aplikantet gra. Po ashtu, edhe te skema kombëtare kemi bonus për fermeret gra.

Siguria ushqimore.

Unë përmenda pak pjesën e veterinarisë dhe të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të cilëve me ligjin e ri të shërbimeve veterinare, që është për miratim, u japim kontrollin nga ferma në tavolinë. Kjo është e lidhur drejtpërdrejt me sigurinë ushqimore, sepse kur kontrolli përgjatë gjithë zinxhirit ushqimor është i fragmentarizuar, vendosja nën monitorim e të gjithë kontrollit ushqimor cedon.

Mendojmë se rregullimet që bën ligji do të na japin një dorë për të vendosur nën kontroll sigurinë ushqimore. Jemi duke punuar shumë për produktet shtazore, sepse ato janë

më problematiket. E themi duke u skuqur, që i kemi të mbyllura dyert e Bashkimit European për të eksportuar pjesën më të madhe të prodhimeve shtazore. Për t'i bindur të hapin tregun duhet që, së pari, të rregullohemi ne së brendshmi. Të gjitha këto atje çojnë.

Gjurmueshmëria, që e përmendi edhe zoti Shalsi, është një nga gjërat që ne duam ta pilotojmë këtë vit me metoda inovative. Jemi duke bashkëpunuar me Irlandën, që është një nga vendet më inovative në drejtim të sigurisë ushqimore. Ditët e fundit po përqendrohemi te disa kompani të një produkti. Për shembull, mjalti. Do ta fillojmë duke pilotuar një produkt, për të aplikuar një sistem gjurmueshmërie, i cili është i kontrollueshëm përmes teknologjisë jo vetëm nga institucionet, por edhe nga konsumatori.

Nëse mbi këtë shishe uji vendosim një barkod, me ndihmën e një smartphone shikojmë të gjithë përbërësit, skadencën, kohën kur është prodhuar, kur është transportuar, ku është magazinuar, emrin e prodhuesit, emrin e burimit, e të tjera. Do të ishte diçka inovative dhe mbase mund të ishim para shumë vendeve të tjera më të zhvilluara. E kemi ambicie, nuk e realizojmë dot për të gjitha prodhimet që këtë vit, por jam i sigurt që për disa prodhime do ta pilotojmë. Do të kemi me të vërtetë një model ku duhet të shkojmë, në mënyrë që në të ardhmen të perfeksionojmë gjurmueshmërinë dhe direkt të forcojmë sigurinë ushqimore në vendin tonë. Ka shumë spekulim dhe panik të përhapur padrejtësisht, ndonëse ne kemi shumë sfida dhe beteja për të fituar në sigurinë ushqimore, por ama shumë të tjera nuk janë të vërteta, sidomos për prodhimet bujqësore.

Unë e vlerësoj shumë punën që bëjnë mediat dhe emisionet investigative, por ndonjëherë ato shkaktojnë panik të pamërituar. Nuk është e vërtetë që ne kemi prodhime me ndotje

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shpeshherë është luftë tregtare. Treguesi që na tregon se cila është cilësia e prodhimeve tona, janë eksportet. Ne e kemi parë të papërfillshëm reklamimin e produkteve që eksportojmë drejt vendeve të Bashkimit European. 66% e prodhimeve tona bujqësore eksportohen drejt vendeve të BE-së, ku standardet janë shumë të larta. Reklamimet apo kthimet janë fare të pallogaritshme, gjë që tregon se prodhimet tona janë të pastra për sa kohë që tregjet më të kultivuara dhe me standardet më të larta si Bashkimi European i pranojnë për konsumatorët e tyre.

Besnik Baraj – Ka ndonjë merak tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lajm që nuk e dinë apo nga ato që dinë? Projekti i madh i Bankës Botërore ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për vitin 2019, projekti i Bankës Botërore për ujitjen me vlerë 23 milionë euro prek një pjesë të mirë të zonës së Lushnjës. Në pak vite ne do të arrijmë në zonën e Lushnjës dhe Divjakës mbulimin 100% të ...

Në të gjithë Shqipërinë mund ta kemi të vështirë, por në Lushnjë, Divjakë dhe Fier është e sigurt që brenda mandatit tonë do të kemi mbulim 100% me ujë të sipërfaqes së punuar.

Besnik Baraj – Përpara se ta mbyll, zoti Ministër, dua të sjell në vëmendje një shqetësim, që e kishte edhe zoti Shalsi. Ne kemi vizituar ISUV-in dhe kemi vënë re që atje vërtet ka kapacitete dhe potenciale. Ata kanë një problem, që për mua është i qenësishëm, lidhur me statusin dhe njëkohësisht dhënien e atij konfiguracioni pozitiv që ka pasur në drejtim të kërkimit shkencor.

Në këtë drejtim, për vetë rëndësinë që ka ai institut në kontrollin e cilësisë së ushqimit, ata konfirmuan që kanë vëmendjen tuaj, bërja e asaj realitet ka një rëndësi shumë të madhe për vendin tonë. Ka shumë gjëra që mund të diskutojmë në këtë drejtim. Në marrjen e mostrës duhet të përfshihen ata dhe jo t'u shkojë mostra e gatshme. Nga pikëpamja e analizës kimike, marrja e mostrës është element jashtëzakonisht i rëndësishëm, që mund të sjellë probleme, dhe duhet ta bëjë po ai që bën analizën ose të paktën të jetë prezent.

Niko Peleshi – Problematika qëndron. Para disa viteve ne kemi bërë një gabim, ku, për të fituar disa para më shumë në buxhet i kemi hequr ISUV-it statusin e institucionit kërkimor-shkencor dhe humbëm 10 profesorë, të cilët ikën nga ISUV-i dhe shkuan në katedrat e universiteteve, sepse rroga aty ishte më e lartë. Për një arsye fare banale kemi humbur kapacitete të mëdha.

Megjithatë, ISUV-i është një institucion që ka ende kapacitete, dhe ne duhet t'i shpëtojmë. Ne e kemi bërë ndryshimin e statusit të projektligji i ushqimit. Me këtë rast ju kërkoj që, kur të vij në komision, ta mbështesni edhe ju. T'i rijapim statusin e institucionit kërkimor-shkencor në mënyrë që të shtojmë akoma më tepër kapacitetet. Në fakt, ata kanë bërë një punë shumë të mirë kohët e fundit. Para një viti ne e filluam me 8 teste të akredituara, kurse tani numri i testeve të akredituara ka shkuar 53, ka shumë të tjera që duhet të akreditohen, por duhen kapacitete.

Siç e thamë, jemi duke implementuar një projekt të pasurimit të laboratorit me pajisje laboratorike.

Besnik Baraj – Plazma e parë që vjen në Shqipëri është tek ai institut.

Niko Peleshi – Ndërkohë, kemi bërë marrëveshje me laboratorë jashtë vendit, si në Belgjikë dhe në Greqi, që sa herë kemi nevojë për teste që nuk i realizojmë dot këtu, t'i

realizojmë nga ata në bashkëpunim. Në fakt, kjo ishte edhe detyrë që na u vu nga audituesit e Brukselit. Pra, është një gjë e vogël që ka shkaktuar probleme të mëdha. Për shkak të banalitetit të prokurimit publik, deri sa të bëhej tenderi për të blerë kitet e analizave, kalonin gjashtë muaj dhe nuk merrnin dot mostra për të zbatuar planin e mbetjeve për 6,7 apo 8 muajt e parë të vitit. Kjo na rrezikoi shumë në raport me Brukselin, por tani po e zgjidhim duke bërë një procedurë që quhet marrëveshje kuadër. Pra, po bëjmë një procedurë prokurimit për tre vjet. Nuk kemi nevojë të bëjmë tender çdo vit, por mbi bazën e kësaj procedure i furnizojmë që në datën 1 janar kitet dhe kemi mundësi të marrim mostra dhe bëjmë analiza për të zbatuar planin e mbetjeve gjatë gjithë vitit.

Këto janë pak a shumë ato që po bëjmë në raport me ISUV-in.

Faleminderit!

Besnik Baraj – Faleminderit juve dhe ekipit tuaj!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA